FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 105

Tiranë – E premte, 19 korrik 2019

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 496, datë 16.7.2019	Për rishpërndarje fondesh në buxhetin e miratuar për vitin 2019 dhe për caktimin e organit përgjegjës, për përdorimin e fondeve të mbledhura nga donatorë të ndryshëm, për rindërtimin e shtëpive të dëmtuara nga tërmeti	7717
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 497, datë 16.7.2019	Për një shtesë në vendimin nr. 289, datë 10.5.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të pasurisë me numër 33/76, zona kadastrale 8523, me sipërfaqe truall 7726 m^2 dhe sipërfaqe ndërtesë 7307 m^2, me vendndodhje në Elbasan"	7717
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 500, datë 17.7.2019	Për disa ndryshime në vendimin nr. 77, datë 20.2.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për planin vjetor të pranimit, për vitin 2019, në institucionet e administratës shtetërore, pjesë të shërbimit civil"	7718
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 502, datë 17.7.2019	Për revokimin e transferimit të së drejtës së pronësisë dhe për një ndryshim në vendimin nr. 760, datë 20.12.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për kalimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të njësisë administrative Tiranë, të disa pronave me vendndodhje në zonat kadastrale 8250, 8240, 8190, 8150"	7718
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 503, datë 17.7.2019	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikonstruksion i rrugës së fshatit Muçaj (UNAZA)", në Bashkinë Vorë	7719
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 504, datë 17.7.2019	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikualifikimi urban i qendrës së qytetit Bilisht", në Bashkinë Devoll	7720
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 505, datë 17.7.2019	Për miratimin e rregullores së organizimit dhe të funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit	7721

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 506, datë 17.7.2019	Për miratimin e kodit të etikës së vullnetarit.....	7729
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 507, datë 17.7.2019	Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Bashkisë Durrës, si qiradhënës, dhe shoqërisë "UNIEURO" sh.p.k., si qiramarrës, për pasurinë "Një pjesë e katit të parë të ish-Repartit të URT-së"	7732
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 508, datë 17.7.2019	Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si qiradhënës, dhe shoqërisë "Blu-Imperial" sh.p.k., si qiramarrës, për pasurinë nr. 94, me emërtimin "ish-grup depot e repartit ushtarak nr. 4025", me vendndodhje në Qafëmollë, Dajt, Tiranë, në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes.....	7742
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 509, datë 17.7.2019	Për disa ndryshime në vendimin nr. 551, datë 18.6.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kritereve dhe të procedurave për pajisjen me certifikatën e lejes profesionale për veprimtaritë studimore-projektuese dhe zbatuese për kërkimin, prodhimin, përpunimin, transportimin, depozitimin dhe tregtimin e lëndëve hidrokarbure"	7753
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 510, datë 17.7.2019	Për kalimin në pronësi, të Bashkisë Tiranë, të disa pasurive të paluajtshme në zonën kadastrale 3292 (Kopshti Botanik) dhe për një ndryshim në vendimin nr. 430, datë 2.7.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Universitetit të Tiranës", të ndryshuar.....	7753
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 511, datë 17.7.2019	Për miratimin e ndryshimit të statusit, nga kategoria e resursit "tokë bujqësore" në "tokë urbane", truall, të pasurisë me numër 78/39, zona kadastrale 3184, Bashkia Durrës.....	7770
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 512, datë 17.7.2019	Për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Vladimir Grosha.....	7775
Urdhër i përbashkët i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, ministrit të Brendshëm dhe ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 292, datë 28.5.2019	Për miratimin e rregullores për zbatimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet tri ministrive "Për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor".....	7775
Njoftim i Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme nr. 10267, datë 15.7.2019	Mbi hyrjen në fuqi të një marrëveshjeje.....	7782
Njoftim i Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme nr. 10269, datë 15.7.2019	Mbi hyrjen në fuqi të një marrëveshjeje shumëpalëshe.....	7782
Vendim i Entit Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 26, datë 31.5.2019	Për licencimin e shoqërisë ujësjellës Peqin sh.a.	7782

Vendim i Entit Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 28, datë 20.6.2019	Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Fushë-Arrëz sh.a...	7784
Vendim i Entit Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 29, datë 20.6.2019	Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Tropojë sh.a.	7786
Vendim i Entit Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 30, datë 20.6.2019	Për miratimin e tarifave të shërbimit të largimit të ujërave të ndotura për shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Malësi e Madhe sh.a.....	7791
	Vendim *(i shkurtuar)* për shpalljen të zhdukur të shtetasit Artan Spanjolli.....	7792
	Vendim *(i shkurtuar)* për shpalljen të vdekur të shtetasit Arianit Skilja.....	7793
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Lulzim Sula.....	7793
	Korrigjim gabimi material në vendimin e ERE-s nr. 95, datë 17.06.2019 "*Mbi miratimin "Udhëzuesit për testimin e tregut për gazsjellësin Trans Adriatik",* botuar në Fletoren Zyrtare nr. 101, datë 12 korrik 2019.....	7793

VENDIM
Nr. 496, datë 16.7.2019

PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E MIRATUAR PËR VITIN 2019 DHE PËR CAKTIMIN E ORGANIT PËRGJEGJËS, PËR PËRDORIMIN E FONDEVE TË MBLEDHURA NGA DONATORË TË NDRYSHËM, PËR RINDËRTIMIN E SHTËPIVE TË DËMTUARA NGA TËRMETI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 99/2018, "Për buxhetin e vitit 2019", dhe të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e miratuar për vitin 2019, për Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Kulturës dhe Fondin Shqiptar të Zhvillimit, bëhet rishpërndarje fondesh, si më poshtë vijon:

a) Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në programin buxhetor "Programe zhvillimi", 06210, i pakësohet fondi prej 70 000 000 (shtatëdhjetë milionë) lekësh në shpenzime kapitale;

b) Ministrisë së Mbrojtjes, në programin buxhetor "Emergjencat civile" 10910, i shtohet fondi prej 40 000 000 (dyzet milionë) lekësh në shpenzime kapitale të brendshme, për rindërtimin e shtëpive të dëmtuara nga tërmeti;

c) Ministrisë së Kulturës, në programin "Trashëgimia kulturore dhe muzetë" 08220, i shtohet fondi prej 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekësh, për restaurimin e muzeut "Mësonjëtorja e parë shqipe", i dëmtuar dhe aktualisht i mbyllur nga tërmeti.

2. Ministria e Mbrojtjes caktohet organ përgjegjës për përdorimin, sipas procedurave të prokurimit publik, të fondeve të mbledhura nga donatorë të ndryshëm për rindërtimin e shtëpive të dëmtuara nga tërmeti.

Ministria e Mbrojtjes të lidhë marrëveshje bashkëpunimi me bashkitë e prekura nga tërmeti, për zbatimin dhe mbikëqyrjen e punimeve për rindërtimin e shtëpive të dëmtuara.

3. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Kulturës dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 497, datë 16.7.2019

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 289, DATË 10.5.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË TË PASURISË ME NUMËR 33/76, ZONA KADASTRALE 8523, ME SIPËRFAQE TRUALL 7726 m^2 DHE SIPËRFAQE NDËRTESË 7307 m^2, ME VENDNDODHJE NË ELBASAN"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 1, të vendimit nr.289, datë 10.5.2019, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

"1/1. Autorizohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë të vendosë në dispozicion të shoqërisë "Ital-Druri", sh.p.k., Elbasan, pasuritë me numër 33/76, zona kadastrale 8523, me sipërfaqe trualli 7 726 (shtatë mijë e shtatëqind e njëzet e gjashtë) m^2 dhe sipërfaqe ndërtesë 7 307 (shtatë mijë e treqind e shtatë) m^2, pronë shtet, me vlerë 188 386 858 (njëqind e tetëdhjetë e tetë milionë e treqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e tetë) lekë, për rritjen e kuotës së kapitalit shtetëror.".

2. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 500, datë 17.7.2019

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 77, DATË 20.2.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PLANIN VJETOR TË PRANIMIT, PËR VITIN 2019, NË INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS SHTETËRORE, PJESË TË SHËRBIMIT CIVIL"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit nr. 77, datë 20.2.2019, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Në paragrafin e parë, shifra 495 bëhet 650;

b) Në shkronjën "a", shifra 8 bëhet 13;

c) Në shkronjën "ç", shifra 235 bëhet 385.

2. Ngarkohet Departamenti i Administratës Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 502, datë 17.7.2019

PËR REVOKIMIN E TRANSFERIMIT TË SË DREJTËS SË PRONËSISË DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 760, DATË 20.12.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KALIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË TIRANË, TË NJËSISË ADMINISTRATIVE TIRANË, TË DISA PRONAVE ME VENDNDODHJE NË ZONAT KADASTRALE 8250, 8240, 8190, 8150"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "a", të nenit 8/a, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Revokimin e transferimit të së drejtës së pronësisë Bashkisë Tiranë, Njësisë Administrative Tiranë, të pronës me numër rendor 10, të lidhjes 1, bashkëlidhur vendimit nr. 760, datë 20.12.2017, të Këshillit të Ministrave.

2. Në lidhjen 1, që i bashkëlidhet vendimit nr. 760, datë 20.12.2017, të Këshillit të Ministrave, prona me numër rendor 10, sipas formularit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, hiqet.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Bashkia Tiranë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE
(Per inventarizimin e pronave te veçanta)

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
6	8240 Tr-R-5	3/11	Truall	Rr. Kavajëa	56.67		Infrastrukturë	DPNR.2PQ	Bashkia	Shtet vol.6, fq 196
7	8240 Tr-R-5	3/54	Trotuar	Rr. Kavajës	495.07		Infrastrukturë	DPNR.2PQ	Bashkia	Shtet, vol 6, fq 220
8	8240 Tr-R-5	3/322	Truall	Rr. Kavajës	557		Infrastrukturë	DPNR.2PQ	Bashkia	Shtet, vol 2, fq 100
9	8190 TR-X-16	12/333	Shesh	Rr. Shefqet Ndroqi	115		Infrastrukturë	DPNR.2PQ	Bashkia	Shtet, v.6, fq 68
10	8190 TR-X-16	12/289	Truall	Rr. Shefqet Ndroqi	858		Infrastrukturë	DPNR.2PQ	Bashkia	Shtet, vol 21, fq 45 Ka ndertim te paligjshëm
11	8190 TR-X-16	12/290	Truall	Rr. Shefqet Ndroqi	4754	1523	Infrastrukturë	DPNR.2PQ	Bashkia	Shtet, vol21, fq 49

REPUBLIKA E SHQIPËRISË SEKRETARIA BASHKIA TIRANË

VENDIM
Nr. 503, datë 17.7.2019

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "RIKONSTRUKSION I RRUGËS SË FSHATIT MUÇAJ (UNAZA)", NË BASHKINË VORË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikonstruksion i rrugës së fshatit Muçaj (Unaza)", në Bashkinë Vorë.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Vorë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë "tokë bujqësore", me sipërfaqe 564 m^2, me vlerë të përgjithshme prej 252 672 (dyqind e pesëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e dy) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 252 672 (dyqind e pesëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e dy) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë Vorë, planifikuar në buxhetin e saj, me vendim të Këshillit Bashkiak.

5. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe të përfundojë tre muaj pas hyrjes në fuqi të tij.

6. Shpenzimet procedurale, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Brendshme.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur pranë Bashkisë Vorë certifikatën e pronësisë, hartën treguese të regjistrimit si dhe kartelën e pasurisë.

8. Afati i përfundimit të punimeve, të objektit në Bashkinë Vorë, të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.

9. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Vorë, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasurinë e shpronësuar, në favor të Bashkisë Vorë.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit në hartën kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Bashkia Vorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lista e pronave dhe e pronarëve që do të shpronësohen për realizimin e projektit: "Rikonstruksion i rrugës së fshatit Muçaj (Unaza)"
Bashkia Vorë

Nr	Emri, Mbiemri (Pronari që shpronësohet)	Zona Kadastrale	Lloji i pasurisë	Numri i pasurisë	Sipërfaqja e prekur/m²	Çmimi i tokës bujqësore/ lekë/m²	Vlera e përgjithshme e shpronësimit	Shënime
1	Xhaferr Hariz Muça	2726-Muçaj	"tokë bujqësore"	18/44	400	448	179,200	Konfirmuar nga ZVRPP
2	Dylaver Hysen Shpati	2726-Muçaj	"tokë bujqësore"	45/5	100	448	44,800	Konfirmuar nga ZVRPP
3	Kolec Geg Biba	2726-Muçaj	"tokë bujqësore"	45/3	64	448	28,672	Konfirmuar nga ZVRPP
	Shuma				**564**		**252 672**	

VENDIM
Nr. 504, datë 17.7.2019

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "RIKUALIFIKIMI URBAN I QENDRËS SË QYTETIT BILISHT", NË BASHKINË DEVOLL

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit: "Rikualifikimi urban i qendrës së qytetit Bilisht", në Bashkinë Devoll.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Devoll.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë "tokë truall" dhe "ndërtesë", me vlerë të përgjithshme prej 873 470.7 (tetëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e katërqind e shtatëdhjetë pikë shtatë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 873 470.7 (tetëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e katërqind e shtatëdhjetë pikë shtatë) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë Devoll, planifikuar në buxhetin e saj, me vendim të këshillit bashkiak.

5. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe të përfundojë tre muaj pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

6. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur certifikatën e pronësisë, hartën treguese të regjistrimit si dhe kartelën e pasurisë, pranë Bashkisë Devoll.

7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit në Bashkinë Devoll të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.

8. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Devoll, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të Bashkisë Devoll.

9. Agjencia Shtetërore e Kadastrës të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit në hartën kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Bashkia Devoll për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lista e pronave dhe e pronarëve që do të shpronësohen për realizimin e projektit: "Rikualifikimi urban i qendrës së qytetit Bilisht"
Bashkia Devoll

Nr	Emri, Mbiemri (Pronari që shpronësohet)	ZK	Nr. pasurisë	Sipërfaqja e truallit/ m²	Çmimi i truallit lekë/m²	Vlera e truallit/lekë	Sipërfaqja e ndërtesës (m²)	Vlera e ndërtesës/ lekë	Vlera e përgjithshme e shpronësimit	Shënime
1	Idris Isaku	1187	5/165	24	2145	51480			51,480	Konfirmuar nga ZVRPP
2	Verore Isaku Maklend Isaku Denisa Isaku	1187	5/567ND				28	749060.7	749060.7	Konfirmuar nga ZVRPP
3	Arjan Begolli	1187	5/580	34	2145	72930			72930	Konfirmuar nga ZVRPP
	Shuma								**873 470.70**	

VENDIM
Nr. 505, datë 17.7.2019

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ORGANIZIMIT DHE TË FUNKSIONIMIT TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË KONTABILITETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 26, të ligjit nr.25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores së organizimit dhe të funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Vendimi nr. 672, datë 26.10.2005, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit", shfuqizohet.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

RREGULLORE
PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT KOMBËTAR TË KONTABILITETIT

KREU I
ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI

Neni 1
Objekti i rregullores

Objekt i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave dhe detyrave të hollësishme të organizimit dhe të funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit (në vijim KKK), kërkesat e posaçme që duhet të përmbushë një kandidat për të qenë anëtar i Këshillit, procedurat e përzgjedhjes dhe rastet e shkarkimit të anëtarëve, procedurat për hartimin e standardeve kontabël kombëtare dhe të produkteve të tjera, të realizuara nga anëtarët e këtij Këshilli ose të tretët.

Neni 2
Objektivat, përgjegjësitë dhe detyrat e KKK-së

1. Objektivat kryesorë të KKK-së janë, si më poshtë vijon:

a) përsosja e vazhdueshme e legjislacionit për kontabilitetin;

b) përpunimi i sistemit kontabël në përputhje me ligjin për kontabilitetin;

c) hartimi dhe përmirësimi i standardeve kombëtare të kontabilitetit;

ç) nxitja e përdorimit dhe zbatimit të standardeve kombëtare të kontabilitetit (SKK) dhe standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar (SNRF);

d) monitorimi i zbatimit të standardeve të kontabilitetit dhe raportimit financiar.

2. Në bazë të ligjit për kontabilitetin, KKK-ja kryen detyrat, si më poshtë vijon:

a) Paraqet propozime pranë ministrit përgjegjës për financat, për përgatitjen ose ndryshimin e legjislacionit në fuqi në fushën e kontabilitetit;

b) Harton SKK-të, në zbatim të ligjit për kontabilitetin;

c) Harton rregulla të tjera dhe rregullore në fushën e kontabilitetit;

ç) Jep shpjegime, interpreton dhe përgjithëson problemet që dalin nga praktika dhe standardet kontabël kombëtare, në formën e udhëzimeve kontabël;

d) Rishikon dhe shpreh opinionet e veta për projektaktet ligjore dhe nënligjore, të cilat përmbajnë dispozita për kontabilitetin dhe profesionet e lira në fushën e kontabilitetit dhe të auditimit;

dh) Organizon punën për përkthimin e SNRF-ve;

e) Jep rekomandime për përgatitjen e specialistëve kontabilistë në institucionet e arsimit të lartë;

ë) Vendos dhe mban kontakte me organizma ndërkombëtarë të kontabilitetit (përfshirë Bordin e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit IASB, institucione dhe organizma të ndryshëm të Bashkimit Evropian si dhe organe të tjera të hartimit të standardeve në vende të tjera) dhe merr pjesë në veprimtaritë ndërkombëtare që lidhen me kontabilitetin;

f) U krijon mundësi anëtarëve dhe stafit të vet të marrin pjesë në konferenca dhe aktivitete të ndryshme profesionale, në Shqipëri dhe jashtë vendit;

g) Publikon në faqen zyrtare të institucionit standardet kombëtare të kontabilitetit dhe standardet ndërkombëtare të raportimit financiar, të detyrueshme për zbatim. Gjithashtu, ka të drejtën të publikojë edhe materiale të tjera, jo të detyrueshme për zbatim, me karakter dhe qëllim informues, në funksion të mbajtjes së kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare;

gj) Boton standardet kombëtare të kontabilitetit dhe materiale të tjera për zbatim në lidhje me këto standarde;

h) Monitoron zbatimin e standardeve të kontabilitetit dhe të raportimit financiar;

i) Organizon tryeza të rrumbullakëta, seminare, konferenca dhe të tjera të ngjashme me to, me qëllim rritjen e transparencës nëpërmjet përfshirjes së palëve të interesit në procesin e përmirësimit të raportimit financiar, informimin e palëve të interesit për zhvillimet në këtë fushë, si dhe nxitjen e zbatimit korrekt të SKK-ve/SNRF-ve nga njësitë ekonomike;

j) Raporton me shkrim pranë ministrit përgjegjës për financat, brenda 3-mujorit të parë të vitit pasardhës, në lidhje me veprimtarinë vjetore të tij;

k) Raporti, sipas shkronjës "j", të këtij neni, ku trajtohen me hollësi edhe problemet e konstatuara gjatë monitorimeve në lidhje me përgatitjen e pasqyrave financiare, si dhe zgjidhjet e sugjeruara, i dërgohet për informacion Bordit të Mbikëqyrjes Publike, brenda afatit të shkronjës "j", të këtij neni;

l) Publikon raportin vjetor në faqen zyrtare të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, brenda afatit të përcaktuar në shkronjës "j", të këtij neni.

3. KKK-ja është e pavarur në hartimin e sistemit kontabël të SKK-ve dhe të rregullimeve të tjera kontabël.

Neni 3

Kërkesat e posaçme që duhet të përmbushë një kandidat për të qenë anëtar i Këshillit

1. Kërkesat e posaçme që duhet të përmbushë një kandidat për të qenë anëtar i këshillit janë, si më poshtë vijon:

a) Të ketë edukim në fushën e kontabilitetit dhe/ose financës;

b) Të jetë ekspert në teorinë dhe metodologjinë e kontabilitetit (me titull /gradë) dhe, të paktën, 5 (pesë) vitet e fundit të jetë i përfshirë drejtpërdrejt në këtë fushë; ose praktikues i licencuar në fushën e kontabilitetit prej jo më pak se 10 (dhjetë) vitesh; ose praktikues i palicencuar në fushën e kontabilitetit prej jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) vitesh;

c) Të ketë figurë të pastër morale dhe autoritet të njohur profesional.

Neni 4

Përfundimi i mandatit të anëtarit të KKK-së

1. Anëtari i KKK-së lirohet nga detyra me përfundimin e afatit 4-vjeçar të mandatit të tij. Ministri përgjegjës për financat nxjerr urdhrin për lirimin e anëtarit të KKK-së që i ka mbaruar mandati.

2. Kryetari i KKK-së, jo më pak se 30 (tridhjetë) ditë përpara përfundimit të mandatit të anëtarit të KKK-së, njofton organin/et propozues/e të atij anëtari për të sjellë propozimet për anëtarin e ri të KKK-së.

3. Kryetari i KKK-së i paraqet ministrit përgjegjës për financat propozimin/propozimet për anëtarin/anëtarët e ri/rinj të KKK-së, ardhur nga organet propozuese, sipas përcaktimeve të bëra në shkronjat "a" "b" "c" dhe "d", të pikës 1, të nenit 25, të ligjit për kontabilitetin.

Neni 5

Dorëheqja e një anëtari të KKK-së

1. Kur një anëtar i KKK-së vendos të tërhiqet nga detyra, duhet t'i paraqesë kërkesë me shkrim për dorëheqje organizmit që e ka propozuar dhe kryetarit të KKK-së, i cili ia përcjell për miratim ministrit përgjegjës për financat.

2. Ministri përgjegjës për financat, jo më vonë se 45 (dyzet e pesë) ditë pas njoftimit me shkrim nga KKK-ja për dorëheqjen e anëtarit të përmendur në pikën 1, të këtij neni, nxjerr urdhrin për mandatimin e një anëtari të ri. Anëtari i ri propozohet nga të njëjtët organizma që kanë propozuar edhe anëtarin që jep dorëheqjen.

Neni 6

Kryetari dhe nënkryetari i KKK-së

1. Kryetari i KKK-së organizon punën për veprimtaritë e mëposhtme:

a) i jep orientime strukturës administrative për përgatitjen e projektprogramit vjetor të punës së KKK-së;

b) organizon mbledhjet dhe përgatit e materialet e mbledhjes si dhe përcakton kohën dhe miraton projektrendin e ditës së mbledhjes;

c) drejton mbledhjet e KKK-së;

ç) nënshkruan/miraton korrespondencën e KKK-së, përveç sa nënshkruhet nga drejtori ekzekutiv në cilësinë e nëpunësit autorizues.

2. Në mungesë të kryetarit, detyrat e tij kryhen nga nënkryetari i KKK-së (në vijim nënkryetari).

Neni 7

Zgjedhja e kryetarit dhe e nënkryetarit

1. Kryetari dhe nënkryetari i KKK-së zgjidhen nga vetë anëtarët e tij. Mandati i tyre është 4-vjeçar, me të drejtë rikandidimi.

2. Procedura për zgjedhjen e kryetarit dhe të nënkryetarit zhvillohet në mbledhjen e parë të përbërjes së re të KKK-së ose në mbledhjen e radhës pas caktimit të një anëtari të ri në vend të kryetarit dhe të nënkryetarit.

3. Mbledhja për zgjedhjen e kryetarit dhe të nënkryetarit zhvillohet kur krijohet kuorumi prej të paktën 5 (pesë) anëtarësh.

4. Kryetari zgjidhet para nënkryetarit. Anëtarët e KKK-së nuk kanë të drejtë abstenimi. Votimi për kryetarin dhe nënkryetarin e Këshillit është i fshehtë. Për zhvillimin e mbledhjes dhe rezultatet e votimit mbahet procesverbal. Për realizimin e procesit të votimit ngrihet një komision prej 3 (tre) anëtarësh të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, të cilët nuk konkurrojnë.

5. Para kryerjes së votimit, anëtari që propozohet duhet të pranojë kandidimin e tij për postet e mësipërme.

6. Kur konkurrojnë disa kandidatë, një anëtar i KKK-së voton vetëm për një kandidat. Nëse konkurron vetëm një kandidat, anëtari i KKK-së voton kundër ose pro tij. Kryetar dhe nënkryetar zgjidhet kandidati që fiton, të paktën, 4 (katër) vota të anëtarëve të KKK-së.

7. Kur në votimin e parë asnjë nga kandidatët nuk ka fituar numrin e nevojshëm të votave, në votimin e dytë votohet vetëm për dy prej atyre që kanë marrë shumicën e votave. E njëjta procedurë ndiqet edhe për zgjedhjen e nënkryetarit.

8. Në rast se kryetari ose nënkryetari nuk zgjidhen për shkak se asnjë nga kandidatët nuk marrin numrin e nevojshëm të votave ose nuk është arritur minimumi i nevojshëm i votave, zgjedhjet përsëriten në një mbledhje tjetër. Nëse kryetari dhe nënkryetari nuk arrijnë të zgjidhen as në mbledhjen e dytë, mbledhja tjetër zhvillohet brenda 10 ditësh pune.

9. Kur për arsyet e përmendura në pikën 8, të këtij neni, kryetari ose nënkryetari nuk arrijnë të zgjidhen në 3 (tri) mbledhje radhazi, atëherë kryetari ose nënkryetari caktohen nga ministri përgjegjës për financat.

Neni 8
Mbledhja

1. Vendimet e KKK-së merren në mbledhjet e këtij Këshilli.

2. Mbledhjet, si rregull, realizohen një herë në muaj, por mund të organizohen sa herë që ka çështje të rëndësishme, që duhet të shqyrtohen.

Neni 9
Thirrja e mbledhjes

1. Mbledhjet thirren nga kryetari. Mbledhja e parë pas krijimit të KKK-së organizohet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e emërimit të anëtarëve të KKK-së dhe në këtë mbledhje zgjidhen kryetari dhe nënkryetari.

2. Njoftimi për mbledhje u dërgohet anëtarëve të KKK-së nga kryetari, me postë, faks ose postë elektronike, të paktën dhjetë ditë para datës së zhvillimit të saj.

3. Njoftimi për mbledhje përcakton kohën, vendin dhe rendin e ditës, si dhe hollësi të tjera të rëndësishme që kanë lidhje me të. Njoftimit i bashkëlidhen materialet që kanë të bëjnë me çështjet e rendit të ditës.

Neni 10
Rendi i ditës së mbledhjes

1. Të gjithë anëtarët e KKK-së mund të propozojnë çështje të rendit të ditës për mbledhjen e ardhshme, të cilat miratohen nga KKK-ja. Në intervalin e kohës ndërmjet dy mbledhjeve, kryetari ka të drejtën të shtojë çështje shtesë në rendin e ditës pa miratimin e anëtarëve të KKK-së.

2. Në mbledhjen e ardhshme përfshihet në rendin e ditës një pikë/çështje për diskutim, e cila në mbledhjen paraardhëse është miratuar me shumicë të thjeshtë votash. Ndonjë pikë/çështje për diskutim që ka qenë e përfshirë në rendin e ditës të mbledhjes së mëparshme, por për shkak të kohës së kufizuar nuk është arritur të trajtohet, kalon automatikisht për diskutim në rendin e ditës të mbledhjes së pasardhëse.

Neni 11
Mbledhja dhe marrja e vendimeve

1. Mbledhjet drejtohen nga kryetari. Në mungesë të tij drejtohen nga nënkryetari. Deri në zgjedhjen e kryetarit, ose në rast se si kryetari ashtu edhe nënkryetari mungojnë, mbledhjet drejtohen nga anëtari më i moshuar i KKK-së.

2. Kuorumi i kërkuar për marrjen e vendimeve në mbledhjet e KKK-së është prania e të paktën 5 (pesë) anëtarëve.

3. Çdo anëtar i KKK-së ka të drejtën e një vote. Anëtarët e KKK-së nuk duhet të abstenojnë në votim. Në rast të votave të barabarta, vota e drejtuesit të mbledhjes është përcaktuese.

4. Standardet kombëtare të kontabilitetit dhe produktet e tjera kontabël, që lidhen me plotësimin e objektivave të KKK-së, të përcaktuara në pikën

1, të nenit 2, të kësaj rregulloreje, miratohen nga të paktën pesë anëtarë të KKK-së. Çështjet e tjera miratohen me një shumicë të thjeshtë votash të numrit të anëtarëve të KKK-së.

5. Anëtari i KKK-së nuk mund të marrë pjesë në votim kur ka konflikt interesi, siç përcaktohet në Kodin e Etikës, të miratuar nga KKK-ja (deri sa KKK-ja të miratojë kodin e vet do të përdoret Kodi i Etikës i Komitetit të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (IFAC)). Kur ka konflikt interesi, anëtari njofton drejtuesin e mbledhjes para se çështja përkatëse të diskutohet në rendin e ditës së kësaj mbledhjeje.

Neni 12

Marrja e një vendimi jashtë mbledhjeve

1. Vendimet e KKK-së mund të merren edhe jashtë mbledhjes. Për marrjen e vendimit në këtë rast, kryetari i KKK-së u përcjell anëtarëve të KKK-së projektvendimin përkatës dhe materialet që lidhen me të dhe cakton një afat jo më pak se 5 (pesë) ditë pune për marrjen e përgjigjeve dhe të reagimeve të anëtarëve.

2. Mënyra e miratimit të projektvendimit përkatës është i njëjtë me atë të parashikuar në pikën 4, të nenit 11, të kësaj rregulloreje. Anëtarët që nuk kthejnë përgjigje brenda afatit të kërkuar do të konsiderohen sikur janë pro vendimit.

3. Rezultatet e votimit pasqyrohen në një procesverbal të posaçëm, sipas nenit 14, të kësaj rregulloreje.

4. Kryetari i KKK-së shpall rezultatet e votimit në mbledhjen e parë, pas afatit të caktuar prej tij për marrjen e përgjigjeve.

Neni 13

Mundësia e pjesëmarrjes në mbledhje

Mbledhjet e KKK-së janë të mbyllura. Përjashtimisht, pjesëmarrja e palëve të interesuara ose publikut vendoset nga drejtuesi i mbledhjes, me miratimin e jo të më pak se 5 (pesë) prej anëtarëve.

Neni 14

Mbajtja e procesverbaleve të mbledhjeve

1. Për mbledhjet e KKK-së mbahen procesverbale të veçanta.

2. Procesverbalet pasqyrojnë:

a) numrin, radhën e mbledhjes;

b) datën dhe vendin e mbledhjes, kohën e fillimit e të mbylljes;

c) emrin e drejtuesit dhe sekretarit të mbledhjes;

ç) emrat e anëtarëve të KKK-së të pranishëm, si dhe emrat e personave të tjerë;

d) rendin e ditës;

dh) vendimet e marra dhe rezultatet e votimit;

e) shënime të mendimeve të pakicës, kur kërkohet nga anëtari që është në pakicë;

ë) hollësi të tjera që gjykohen të rëndësishme.

3. Mendimi me shkrim i pakicës së anëtarit të KKK-së paraqitet në sekretari, i nënshkruar menjëherë pas votimit të vendimit me të cilin lidhet mendimi në fjalë, por jo më vonë se ditën pasardhëse të punës.

4. Procesverbalet e mbledhjes nënshkruhen nga kryetari, sekretari dhe nga anëtari i KKK-së që ka shprehur mendimin në pakicë. Kryetari mban përgjegjësi për pasqyrimin e saktë dhe të plotë të vendimit të marrë dhe të rezultateve të votimit.

5. Procesverbalet origjinale të nënshkruara, njoftimi për mbledhje dhe materialet shoqëruese arkivohen në zyrat e KKK-së.

Neni 15

Komisionet e veçanta të përhershme ose të përkohshme

1. Me qëllim që të përmbushë detyrat e veta, KKK-ja mund të ngrejë komisione të posaçme/të specializuara, të përhershme ose të përkohshme.

2. Komisionet e posaçme/të specializuara, të përhershme ose të përkohshme, mund të përfshijnë, përveç anëtarëve të KKK-së, edhe specialistë të tjerë me kontribut të spikatur në fushën e kontabilitetit ose fusha të tjera, por jo më shumë se shtatë anëtarë.

3. Komisionet e posaçme/të specializuara, të përhershme ose të përkohshme, ngrihen kur vendoset nga shumica e thjeshtë e anëtarëve të KKK-së.

4. Anëtarët e komisioneve të posaçme, të përkohshme apo të përhershme, për realizimin e detyrave të tyre, angazhohen me kohë jo të plotë pune.

5. Komisionet e posaçme/të specializuara, të përhershme ose të përkohshme, ngrihen:

a) për të zhvilluar strategji për veprimtarinë e KKK-së në tërësi ose në fusha të caktuara;

b) për të hartuar një SKK të ri ose për të përmirësuar një SKK ekzistues;

c) për të hartuar rregulla dhe rregullore të tjera në fushën e kontabilitetit dhe profesionet e kontabilitetit;

ç) për të diskutuar problemet dhe për të propozuar zgjidhje, në lidhje me çështje të veçanta të kontabilitetit;

d) për të rishikuar dhe për të shprehur mendimet e tij për projektligje dhe rregullore të ndryshme, të cilat përmbajnë dispozita të veçanta mbi kontabilitetin dhe profesionet e lidhura me të;

dh) për të ndjekur dhe për të rishikuar procesin e përkthimit të SNRF-ve;

e) për çështje të tjera lidhur me misionin e KKK-së.

6. Institucioni i KKK-së ka të drejtë të kontraktojë të tretë për shërbime të ndryshme, në lidhje me përmbushjen e detyrave të veta, duke respektuar dispozitat ligjore në fuqi në lidhje me prokurimin publik.

7. Rekomandimet dhe dokumentet e tjera të përgatitura nga komisionet e posaçme/të specializuara, të përhershme ose të përkohshme, dhe nga të tretët bëhen efektivë kur miratohen nga KKK-ja, sipas rregullave të votimit të përcaktuara në pikën 4, të nenit 11, të kësaj rregulloreje.

KREU II
PROCEDURAT E PËRZGJEDHJES DHE RASTET E SHKARKIMIT TË ANËTARËVE

Neni 16
Procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të KKK-së

1. Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit përbëhet nga 7 anëtarë, prej të cilëve:

a) 1 (një) anëtar propozohet nga organizata profesionale e auditimit ligjor;

b) 1 (një) anëtar propozohet nga shoqatat profesionale të kontabilitetit;

c) 1 (një) anëtar propozohet nga dhomat e tregtisë (përfaqësues të njësive ekonomike të mëdha ose njësive ekonomike me interes publik) ose nga shoqata e bankave;

ç) 3 (tre) anëtarë propozohen nga ministria përgjegjëse për financat, ku njëri prej të cilëve është përfaqësues i strukturës përgjegjëse për administrimin e të ardhurave;

d) 1 (një) anëtar propozohet nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike.

2. Anëtarët e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit duhet të plotësojnë kriteret specifike të paraqitura në nenin 3, të kësaj rregulloreje.

3. Në rastin e anëtarit që përzgjidhet sipas shkronjave "b" dhe "c", të nenit 16, të kësaj rregulloreje, njoftimi për fillimin e procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të KKK-së, mënyra e vlerësimit të kandidatëve bazuar në kriteret e parashikuara në këtë rregullore, vendi dhe afati i dorëzimit të dokumentacionit caktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për financat.

4. Në rastin e anëtarit që përzgjidhet sipas shkronjave "a", "ç" dhe "d", të nenit 16, të kësaj rregulloreje, institucionet përkatëse paraqesin drejtpërdrejt kandidaturat pranë ministrisë përgjegjëse për financat. Këto institucione janë përgjegjëse për plotësimin e kritereve të posaçme, të parashikuara në nenin 3, të kësaj rregulloreje, për kandidaturat e paraqitura për miratim nga ministri përgjegjës për financat.

5. Njoftimi i konkurrimit për anëtar të Këshillit përmban të dhënat, si më poshtë vijon:

a) Një përshkrim të shkurtër të kompetencave e të funksionit që do të mbulojë anëtari;

b) Kërkesat për pranimin e kandidatëve;

c) Listën e dokumenteve që duhet të paraqiten, vendin ku do të paraqiten dhe afatin deri kur do të paraqiten dokumentet;

ç) Mënyrën dhe kohën kur do të shpallet lista e kandidatëve që do të kualifikohen.

Njoftimi publikohet në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për financat, në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Qendrës së Botimeve Zyrtare dhe në faqen zyrtare të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit.

6. Përzgjedhja e kandidatëve për anëtarë të Këshillit, sipas pikës 3, të këtij neni, kryhet nga një komision *ad-hoc,* i ngritur me urdhër të ministrit përgjegjës për financat, i cili ka për detyrë të shqyrtojë dokumentacionin e paraqitur dhe të hartojë listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret ligjore.

7. Kandidatët, që aplikojnë për anëtarë të Këshillit, sipas pikës 3, të këtij neni, dorëzojnë në ministrinë përgjegjëse për financat dokumentacionin e mëposhtëm:

a) kërkesën me shkrim;

b) kopje të pasaportës ose të kartës së identitetit (ID);

c) *Curriculum vitae*;

ç) rekomandime që vërtetojnë figurën e pastër morale dhe autoritetin profesional të kandidatit;

d) kopje të noterizuar të librezës së punës;

dh) kopje të noterizuar të diplomës;

e) kopje të noterizuara të dëshmive e të certifikatave të trajnimeve e të kualifikimeve pasuniversitare;

ë) dëshminë e penalitetit.

Dokumentet e përcaktuara në shkronjën "e", të përfituara jashtë vendit, duhet të jenë të legalizuara, sipas legjislacionit në fuqi.

8. Afati i dorëzimit të dokumentacionit është brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune nga data e shpalljes së njoftimit.

9. Komisioni *ad-hoc*, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e mbylljes së afatit të dorëzimit të dokumentacionit, shqyrton dokumentacionin dhe harton listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret e nenit 3, të kësaj rregulloreje, të shoqëruar me një relacion përmbledhës, i cili i paraqitet për miratim ministrit përgjegjës për financat.

Në relacion, komisioni i rekomandon ministrit të Financave dhe Ekonomisë emërimin e kandidaturave.

Neni 17
Rastet e shkarkimit të një anëtari

1. Kryetari i KKK-së njofton menjëherë ministrin përgjegjës për financat nëse janë rrethanat e përmendura në pikën 7, të nenit 25, të ligjit për kontabilitetin. Ministri përgjegjës për financat gjykon mbi rrethanat, dhe nëse e çmon të arsyeshme, nxjerr urdhrin për heqjen e mandatit të një anëtari të KKK-së ose njofton kryetarin e KKK-së në rast mospranimi për heqjen e mandatit.

2. Një anëtar i KKK-së konsiderohet se nuk përmbush kërkesat e kësaj rregulloreje dhe mund t'i hiqet mandati kur:

a) nuk i pranon ose nuk i përmbush detyrimet në KKK;

b) shkel rëndë Kodin e Etikës profesionale të miratuar nga KKK-ja (deri sa KKK-ja të miratojë një kod të tillë, do të përdoret si bazë "Kodi i Etikës së Kontabilistëve Profesionistë" i IFAC (Komiteti i Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve);

c) nuk merr pjesë në të paktën 50% të mbledhjeve gjatë një viti, pa arsye;

ç) dënohet me vendim të formës së prerë;

d) për shkak të sëmundjeve fizike ose mendore, që e bëjnë të paaftë për të kryer funksionet e ngarkuara.

3. Në rastin e shkarkimit të një anëtari, ministri përgjegjës për financat nxjerr urdhrin për mandatimin e një anëtari të ri, i cili duhet të miratohet jo më vonë se 45 (dyzet e pesë) ditë pas marrjes së njoftimit të përmendur në pikën 1, të këtij neni, sipas procedurave të përzgjedhjes, të përcaktuara në nenin 16, të kësaj rregulloreje.

KREU III
PROCEDURAT PËR HARTIMIN DHE MIRATIMIN E STANDARDEVE KOMBËTARE TË KONTABILITETIT DHE PROCEDURAT PËR PËRKTHIMIN E SNRF-ve

Neni 18
Standardet kombëtare të kontabilitetit

1. SKK-të hartohen në koherencë me SNRF-të. Në raste të justifikuara, ato mund të përmbajnë përjashtime nga SNRF-të, zbatime të thjeshtuara ose shmangie nga SNRF-të, për të gjitha ose një pjesë të njësive ekonomike. Në rast përjashtimesh, SKK-të korresponduese përshkruajnë dhe paraqesin arsyet pse janë të nevojshme.

2. SKK-të u referohen SNRF-ve përkatëse, në bazë të të cilave ato janë përgatitur.

Neni 19
Procedurat për miratimin e standardeve kombëtare të kontabilitetit

1. Sa herë që IASB-ja nxjerr një SNRF të re ose të ndryshuar, KKK-ja vlerëson nevojën për nxjerrjen e një SKK-je të re ose përmirësimin e një SKK-je ekzistuese.

2. Procedura për miratimin e një standardi kombëtar të kontabilitetit, të ri ose të përmirësuar, përmban hapat, si më poshtë vijon:

a) miratimin e objektpërmbajtjes së standardit kombëtar të kontabilitetit, të re ose të përmirësuar;

b) miratimin e komisionit të posaçëm / specializuar dhe të grupit të punës, ku mund të përfshihen edhe ekspertë jashtë KKK-së;

c) caktimin e afatit kohor për hartimin e SKK-së;

ç) projektstandardi kombëtar i kontabilitetit (pika 4, e nenit 11) miratohet kur votohet nga të paktën 5 (pesë) anëtarë të KKK-së;

d) organizimi i disa tryezave të rrumbullakëta, në një periudhë jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë për të diskutuar projektstandardin kombëtar të kontabilitetit, të ri ose të përmirësuar, me palët kryesore të interesuara (shoqatat e profesionit, përfaqësues të bankave të nivelit të dytë, përfaqësuesit e organeve tatimore, kompanitë audituese etj.);

dh) publikimi i projektstandardit kombëtar të kontabilitetit në faqen e internetit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit dhe dërgimi i tij për komente palëve të tjera të përfshira në këtë proces. Afati për komente është të paktën 3 muaj nga data e publikimit të projektstandardit kombëtar të kontabilitetit. Në rast se gjykohet e nevojshme nga KKK-ja, projektstandardi kombëtar i kontabilitetit publikohet sërish për komente, për një periudhë të re tremujore. Kjo dispozitë nuk zbatohet në rastet kur një rregullim ligjor i caktuar hyn në fuqi përpara afatit të përcaktuar në këtë shkronjë;

e) marrja në shqyrtim e të gjitha komenteve të siguruara sipas shkronjave "d" dhe "dh" dhe reflektimi i atyre komenteve që miratohen te projektstandardi kombëtar i kontabilitetit, i ri ose i përmirësuar;

ë) miratimi në Këshill i SKK-së përfundimtare dhe dërgimi te ministri përgjegjës për financat;

f) shpallja e SKK-së për zbatim nga ministri përgjegjës për financat;

g) publikimi i SKK-së, së re ose të përmirësuar, në Fletoren Zyrtare, faqen e internetit të ministrisë përgjegjëse për financat dhe në faqen e internetit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit.

Neni 20

Procedurat për përkthimin e standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar

1. Në mbështetje të ligjit për kontabilitetin, pikën 4, të nenit 3 të tij, SNRF-të përkthehen në gjuhën shqipe, nën përgjegjësinë e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, pa ndryshime nga teksti origjinal në gjuhën angleze dhe shpallen të detyrueshme për zbatim me urdhër të ministrit përgjegjës për financat. KKK-ja për të siguruar përkthimin e SNRF-ve ngre komitetin e rishikimit (KR) të SNRF-ve të përkthyera, në dispozicion të të cilit vendos logjistikën e nevojshme.

2. Komiteti i rishikimit përbëhet nga dy përkthyes dhe dy ose më shumë rishikues. Komiteti i rishikimit ka mandat dyvjeçar. Zgjedhja e anëtarëve rishikues të komitetit të rishikimit bëhet sipas dokumentit "Procesi zyrtar i rishikimit të përkthimit në gjuhën shqipe të SNRF-ve", miratuar nga grupi i përkthimit, adoptimit dhe të drejtës së autorit pranë fondacionit të SNRF (IFRS *Foundation*). Anëtarët e komitetit të rishikimit nuk kanë kufizime mandati për t'u rizgjedhur.

3. Procesi i përkthimit është shërbim kundrejt pagesës ndërsa procesi i rishikimit është shërbim pa pagesë. Tarifat e shpërblimit për përkthimin i referohen rregullimeve me aktet nënligjore në fuqi.

4. Stafi administrativ i KKK-së është koordinatori i procesit të përkthimit. Stafi organizon punën, për:

a) përgatitjen e paketave të materialeve për përkthim;

b) shpërndarjen e materialeve të përkthyera tek rishikuesit;

c) përgatitjen mbi baza vjetore të variantit të konsoliduar të SNRF-ve të përkthyera në gjuhën shqipe;

ç) mirëmbajtjen e platformave elektronike të komunikimit në grup me anëtarët e komitetit të rishikimit.

5. Pas miratimit nga KKK-ja, SNRF-të e përkthyera dhe të rishikuara dërgohen te ministri përgjegjës për financat, i cili bën për shpalljen e tyre të detyrueshme për zbatim. Pas shpalljes, ato publikohen në Fletoren Zyrtare, në faqen e internetit të ministrisë përgjegjëse për financat dhe në faqen e internetit të KKK-së.

6. Varianti i konsoliduar i SNRF-ve të përkthyera në gjuhën shqipe, përgatitur nga stafi administrativ i KKK-së publikohet në faqen e internetit të KKK-së.

KREU IV
ÇËSHTJE ADMINISTRATIVE DHE TË TJERA

Neni 21

Mbështetja administrative dhe teknike

1. Veprimtaritë e KKK-së mbështeten nga një

personel i nevojshëm administrativ e teknik, i cili emërohet nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit.

2. Për mënyrën e organizimit, detyrat dhe përgjegjësitë e strukturës administrative hartohet një rregullore e brendshme, e veçantë, e cila miratohet nga KKK-ja.

3. Zyrat, struktura, organika dhe pagat e personelit administrativ miratohen nga Këshilli i Ministrave.

VENDIM
Nr. 506, datë 17.7.2019

PËR MIRATIMIN E KODIT TË ETIKËS SË VULLNETARIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 27 e 29, pika 1, të ligjit nr. 45/2016, "Për vullnetarizmin", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kodit të etikës së vullnetarit, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet ministria përgjegjëse për çështjet e punësimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

KODI I ETIKËS SË VULLNETARIT

Neni 1
Vullnetarizmi

Vullnetarizmi është një forcë pozitive për një qytetari të përgjegjshme, veprim social, shërbime cilësore, komunitete dhe shoqëri civile të shëndetshme. Vullnetarizmi e bën shoqërinë më të ndjeshme dhe të kujdesshme.

Neni 2
Qëllimi

Kodi i etikës së vullnetarit ka për qëllim të vendosë disa rregulla formale për sjelljen e vullnetarëve në Republikën e Shqipërisë.

Neni 3
Subjekti

Ky kod zbatohet për të gjithë personat që ushtrojnë veprimtarinë e vullnetarizmit në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 4
Trajtimi me respekt

Vullnetari trajtohet me mirësjellje dhe respekt nga të gjithë personat e lidhur me procesin e vullnetarizmit.

Neni 5
Partneriteti

Individi, që zgjedh të kryejë punë vullnetare, shpreh dëshirën e tij për të kontribuar dhe bashkëpunuar. Për këtë arsye, zgjedhja e tij e detyron ofruesin e vullnetarizmit të formulojë rregulla që rregullojnë partneritetin e tij me vullnetarin dhe t'i shohë këto rregulla si pjesë e pandashme e të drejtave të vullnetarit.

Neni 6
Informacioni

1. Vullnetari ka akses ndaj informacionit të ofruesit të vullnetarizmit për çështjet e punës së tij vullnetare, si politikat, rregulloret, planet e punës dhe raportet fiskale.

2. Vullnetari merr informacion të detajuar për pozicionin e vendit të punës që i është ofruar, sasinë e kohës dhe burimet që kërkohen për kryerjen e punës. Gjithashtu, ai ka të drejtë të marrë informacion të shkruar për të drejtat e tij si vullnetar.

Neni 7
Mosdiskriminimi

Vullnetari nuk diskriminohen për shkak të gjinisë, orientimit seksual, statusit martesor, shtatzënisë, të qenit prind, moshës, besimit fetar, shtetësisë, origjinës, racës, prejardhjes, përkatësisë politike, aftësisë së kufizuar ose të qenit i lidhur me një person me aftësi të kufizuara apo për shkak se ka kryer një vepër penale, për të cilën ai ka kryer dënimin sipas legjislacionit në fuqi. Përcaktimet e

vendosura këtu nuk aplikohen nëse një pozicion specifik shërbimi vullnetar kërkon kufizime.

Neni 8
Pozicioni i punës

Duke marrë në konsideratë qëllimet dhe kërkesat e ofruesit të vullnetarizmit, vullnetari ka të drejtë të zgjedhë një pozicion që përputhet me prirjen dhe aftësinë e tij personale, arsimimin dhe eksperiencën e tij të punës.

Neni 9
Koha e punës vullnetare

Në përputhje me nenin 11, të ligjit nr.45/2016, "Për vullnetarizmin", dhe duke pasur parasysh politikat, qëllimet dhe kërkesat e ofruesit të vullnetarizmit, vullnetari, në bashkëpunim me ofruesin e vullnetarizmit, përcakton sasinë e kohës që ai i kushton kryerjes së punës vullnetare.

Neni 10
Rritja profesionale

Në varësi të nevojave të ofruesit të vullnetarizmit, vullnetari ka të drejtë për rritje dhe zhvillim profesional në punë, bazuar në preferencat e tij personale dhe aftësitë e tij.

Neni 11
Kushtet e punës vullnetare

Vullnetari ka të drejtë të ketë kushte të përshtatshme pune. Atij i vihen në dispozicion të gjitha burimet dhe kushtet fizike të nevojshme për të kryer punën e tij vullnetare dhe punon në një mjedis pune të sigurt. Nevojat e vullnetarit me aftësi të kufizuar (PAK) merren në konsideratë në mënyrë të veçantë.

Neni 12
Vlerësimi

Në përfundim të kontratës së vullnetarizmit, ofruesi i vullnetarizmit vlerëson punën/shërbimin e kryer/ofruar nga vullnetari.

Neni 13
Kryerja e detyrës

Vullnetari ka për detyrë ta bëjë në mënyrën më të mirë të mundshme punën e tij.

Neni 14
Dhuratat gjatë kryerjes së punës vullnetare

Vullnetari nuk duhet të pranojnë dhurata apo përfitime të asnjë forme nga përfituesit e vullnetarizmit apo persona të tjerë.

Neni 15
Konflikti i interesit

Vullnetari ka për detyrë të shmangë konfliktet e interesit. Vullnetari, që e gjen veten e tij në një konflikt interesi, duhet ta vetëdeklarojë atë. Vullnetari shmang përfshirjen në çdo formë vetëpunësimi ose biznesi privat, që konkurron me shërbimet apo programet e ofruesit të vullnetarizmit ku ai ushtron vullnetarizmin.

Neni 16
Influencimi i vullnetarëve të tjerë

1. Vullnetari nuk përdor pozicionin e tij si vullnetar për të influencuar vullnetarët e tjerë, stafin ose ofruesin e vullnetarizmit.
2. Vullnetari, që mund të gjendet në një pozicion autoriteti, nuk duhet të abuzojë, të ushtrojë influencë të papërshtatshme apo të kërcënojë një vullnetar tjetër apo anëtar të organizatës/ofruesit të vullnetarizmit.

Neni 17
Përdorimi i pijeve alkoolike dhe substancave narkotike gjatë detyrës

Vullnetari nuk duhet të paraqitet nën efektin e pijeve alkoolike apo të substancave narkotike dhe nuk duhet t'i përdorë ato në vendin e ofrimit të vullnetarizmit.

Neni 18
Komunikimi/ndërveprimi me të tjerët

1. Vullnetari nuk përdor fjalë të papërshtatshme dhe nuk shqetëson vullnetarët e tjerë apo pjesëtarë të ofruesit të vullnetarizmit.

2. Vullnetari ndërvepron me vullnetarët e tjerë, stafin e ofruesit të vullnetarizmit dhe anëtarët e publikut në mënyrë profesionale, të sjellshme, dinjitoze, të respektueshme, të drejtë e të barabartë.

3. Vullnetari nuk vë në lojë apo në siklet një punonjës apo një vullnetar tjetër. Kjo mund të përfshijë fjalë që mund të jenë ofenduese ose dëmtuese ndaj marrëdhënies së vullnetarizmit.

4. Vullnetari nuk sillet në mënyrë të tillë që shqetëson, poshtëron ose krijon një ambient jo të rehatshëm pune për vullnetarët e tjerë.

5. Vullnetari nuk ngacmon të tjerët për shkak të racës, prejardhjes, kryerjes së një vepre penale, për të cilën ai ka kryer dënimin sipas legjislacionit në fuqi, statusit martesor, statusit të partneritetit me partner të së njëjtës gjini, statusit familjar apo aftësisë së kufizuar.

6. Vullnetari trajton këdo me dinjitet dhe respekt.

Neni 19
Procedura e ankimit

1. Në rast se një vullnetar beson se ai apo ajo është trajtuar në kundërshtim me këtë kod etike:

a) ai komunikon drejtpërdrejtë me personin dhe i kërkon që të ndalojë sjelljen e tij/saj;

b) njofton mbikëqyrësin e tij/saj apo koordinatorin e programit;

c) mbikëqyrësi i vullnetarit takohet me personin për të cilin është bërë ankesa, për t'i dhënë atij/asaj një mundësi për të paraqitur këndvështrimin e tij të gjërave;

ç) mbikëqyrësi i vullnetarit merr një deklaratë me shkrim nga personi, ndaj të cilit është bërë ankesa, që qartëson se ata janë në dijeni për ankesën e bërë ndaj tyre dhe e orienton atë të mos e diskutojë ankesën me asnjë person tjetër;

d) mbikëqyrësi i vullnetarit (bashkë me drejtuesin e seksionit të ofruesit të vullnetarizmit) konstaton nëse ankesa është substanciale dhe marrin vendime të veçanta, në varësi të rastit.

2. Ankesa e vullnetarit merret me shkrim dhe me firmën e tij. Ankesa përmban detaje të sjelljes së pretenduar, duke përfshirë datat, kohën, vendet, emrat e individëve të përfshirë dhe çdo dëshmi apo prova.

Neni 20
Marrja e masave

Kur vendoset se ndaj veprimeve të një vullnetari duhet të ndërmerren masa disiplinore, këto masa mund të përfshijnë, por jo të jenë të kufizuara në,:

a) kërkimin e faljes;

b) trajnim të mëtejshëm;

c) paralajmërim;

ç) pezullim;

d) përfundim.

Neni 21
Ofruesi i vullnetarizmit

Ofruesi i vullnetarizmit:

a) vlerëson dhe njeh rolin e çdo vullnetari;

b) shpjegon rolin e çdo vullnetari ndaj klientëve;

c) edukon stafin për vullnetarizmin;

ç) siguron që pajisjet apo ambientet fizike ku ushtrohet vullnetarizmi të jenë të sigurta për vullnetarët;

d) respekton aftësitë e ndryshme të vullnetarëve;

dh) respekton motivet e tyre për t'u marrë me vullnetarizëm;

e) respekton konfidencialitetin në shkallën më të lartë që është e mundur;

ë) mbështet vullnetarët që të kenë rritje personale gjatë këtij procesi;

f) respekton të drejtat, dinjitetin dhe vlerën e të gjithë njerëzve të përfshirë në vullnetarizëm, pavarësisht gjinisë, aftësisë apo prejardhjes kulturor të tyre;

g) siguron që eksperienca e vullnetarizmit të jetë një eksperiencë pozitive.

Neni 22
Dispozita të fundit

Vullnetari duhet të njohë dhe të sillet në përputhje me rregullat e përcaktuara në ligjin nr. 45/2016, "Për vullnetarizmin" dhe legjislacionin tjetër në fuqi, Kodin e Etikës së Vullnetarit si dhe rregullat e përcaktuara nga ofruesi i vullnetarizmit për të rregulluar procesin e vullnetarizmit.

Kodi i Etikës së Vullnetarit vendoset në vende të dukshme të zyrave të ofruesve të vullnetarizmit. Gjithashtu, çdo informacion që ka të bëjë me detyrat dhe përgjegjësitë e vullnetarit e të ofruesit të vullnetarizmit, sipas ligjit nr. 45/2016 "Për vullnetarizmin", bëhet publik në vende të dukshme të zyrave të ofruesve të vullnetarizmit.

VENDIM
Nr. 507, datë 17.7.2019

PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR LIDHJEN E KONTRATËS SË QIRASË ME TARIFËN 1 EURO/KONTRATA, NDËRMJET BASHKISË DURRËS, SI QIRADHËNËS, DHE SHOQËRISË "UNIEURO" SHPK, SI QIRAMARRËS, PËR PASURINË "NJË PJESË E KATIT TË PARË TË ISH-REPARTIT TË URT-së"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të aktit normativ me fuqinë e ligjit nr. 4, datë 9.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve", miratuar me ligjin nr. 9967, datë 24.7.2008, të ndryshuar, dhe në vijim të vendimit nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontratave të tjera të pasurisë shtetërore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Bashkisë Durrës, si qiradhënës, dhe shoqërisë "UNIEURO" sh.p.k., si qiramarrës, për pasurinë "Një pjesë e katit të parë të ish-Repartit të URT-së, me nr. pasurie 2/423, ZK 8513, me sipërfaqe të përgjithshme 930 m^2, nga ku sipërfaqe ndërtimi 900 m^2 dhe sipërfaqe funksionale 30m^2", në pronësi të Bashkisë Durrës, për një periudhë 8-vjeçare, sipas genplanit dhe tekstit të projektkontratës, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Bashkia Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS

Nr. 1334/2 Prot. Durrës, më 28 / 3 / 2019

PROJEKTKONTRATË E NEGOCIUAR NDËRMJET PALËVE PËR DHËNIEN ME QIRA ME ÇMIMIN SIMBOLIK 1 EURO/KONTRATA, TË NJË PJESE TË KATIT TË PARË TË ISH REPARTIT TË URT-SË, ME NR. PASURIE 2/423, ZK 8513, ME SIPËRFAQE TË PËRGJITHSHME 930 M² (NGA KJO SIP. NDËRTIMI 900 M² DHE SIP. FUNKS. 30 M²).

Në Durrës, sot me datë 18 të muajit 03 të vitit 2019 (dymijëenëntëmbëdhjetë), lidhet kjo kontratë qiraje me palë:

BASHKIA DURRËS: Përfaqësuar nga Kryetari i saj z. Vangjush Dako, që më poshtë do të quhet "Qiradhënës" dhe

SUBJEKTI SHOQËRIA "UNIEURO" SHPK, me administrator z. Arian Gjyzeli, administrator i subjektit shoqëria "UNIEURO" shpk, i identifikuar si person juridik me numër identifikimi (NUIS) me NIPT K7814508A, që më poshtë do te quhet "Qiramarrësi", me adresë selie Rrashbull, fshati Vrinë (pranë nënstacionit Fllakë), Durrës, me numër identifikimi H40213060J, me adresë banimi Rrashbull, fshati Vrinë (pranë nënstacionit Fllakë), Durrës.

Mbështetur në Vendimin nr. 54, datë 05.02.2014 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyres së dhënjes me qira, emfiteoze, apo kontrata të tjera të pasurise shteterore", i ndryshuar, në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", VKM-së nr.536, datë 01.05.2008 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike të shtetit që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Durrës", Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 495, datë 23.04.2018, bazuar në nenet 801-825 të Kodit Civil, si dhe kërkesës së subjektit Arian Gjyzeli, së bashku me "Qiramarrësin", palët bien dakord të hartojnë këtë kontratë, me kushtet si më poshtë:

NENI I
OBJEKTI I KONTRATËS

Objekti i kësaj kontrate është dhënia me qira e pasurisë me nr. 2/423, ZK 8513, me sipërfaqe të përgjithshme 930 m² (nga kjo sip. ndërtimi 900 m² dhe sip. funks. 30 m²) pronë e bashkisë Durrës, sipas genplanit dhe dokumentit të ZVRPP-së , bashkëlidhur kontratës.

NENI 2
QËLLIMI I PËRDORIMIT

Qëllimi i kësaj kontrate është dhënia në gëzim të përkohshëm i objektit të përcaktuar në nenin 1, për t'u përdorur për prodhimin e çantave prej letre dhe tekstili, me rregjim pune përpunim aktiv i mallrave (FASON), sipas autorizimit të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

NENI 3
KOHËZGJATJA

Kjo kontratë është e vlefshme për 8 (tetë) vjet dhe hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët.

NENI 4
TË DREJTAT DHE DETYRIMET E QIRADHËNËSIT

4.1 "Qiradhënësi", dorëzon pronën e përcaktuar në nenin 1 të saj, të lirë për t'u shfrytëzuar për qëllimin e kësaj kontrate. Në momentin e dorëzimit do të hartohet procesverbali i dorëzimit të objektit që jepet me qira i shoqëruar me foto, i cili është pjesë përbërëse e kontratës.
4.2 "Qiradhënësi" ka të drejtë të kontrollojë në çdo kohë për respektimin e kushteve të kësaj kontrate nga ana e "Qiramarrësit".
4.3 "Qiradhënësi" ka të drejtë që, në çdo kohë gjatë kohëzgjatjes së kontratës, nëpërmjet njësisë monitoruese të kontratës së qirasë, të monitorojë kontratën për verifikimin e zbatimit të kushteve të përcaktuara në të.
4.4 "Qiradhënësi" është i detyruar të garantojë "Qiramarrësin" për gëzimin e qetë të sendit, objekt të kësaj kontrate ndaj të tretëve, të cilët mund të ngrenë pretendime për të drejtën e tyre mbi këtë pronë.
4.5 "Qiradhënësi" ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës kur Qiramarrësi shkel detyrimet e marra përsipër, duke njoftuar këtë të fundit 30 ditë përpara me shkrim.
4.6 "Qiradhënësi" nuk është i detyruar të garantojë Qiramarrësin nga shqetësimet e të tretëve që nuk pretendojnë të kenë të drejta mbi pronën.

NENI 5
TË DREJTAT DHE DETYRIMET E QIRAMARRËSIT

5.1 "Qiramarrësi" ka të drejtë që, sipas legjislacionit në fuqi, të përdorë e të gëzojë pronën e marrë me qira dhe përmirësimet e bëra në të, për gjithë kohën që është në fuqi kjo kontratë.
5.2 "Qiramarrësi" ka për detyrë që të përdorë sendin, objekt të kësaj kontrate, për qëllimin e parashikuar në nenin 2, në përputhje me detyrimet ligjore që rrjedhin nga legjislacioni shqiptar.
5.3 "Qiramarrësi" detyrohet që, në pasurinë e marrë me qira, të realizojë aktivitetin sipas nenit 2 të kësaj kontrate, duke investuar sipas fazave dhe vlerave të shprehura në plan biznesin e paraqitur në komisionin e vlerësimit të dokumenteve.
5.4 "Qiramarrësi" detyrohet të shfrytëzojë dhe të mirëmbajë objektin e kontratës së qirasë.

5.5 "Qiramarrësi" detyrohet të përballojë me shpenzimet e tij, detyrimet që lidhen me dëmet e shkaktuara eventualisht palëve të treta.
5.6 "Qiramarrësi" detyrohet të sigurojë objektin e kontratës së qirasë, nëpërmjet policës së sigurimit.
5.7 "Qiramarrësi", në funksion të zhvillimit të aktivitetit, në pasurinë objekt i kësaj kontrate, do të investojë vlerën 5.000.000 (pesëmilion) lekë, që konsiston në përmirësimin e objektit

Sipas planbiznesit të paraqitur, në konkurrim, ky investim do të realizohet si vijon:

- Brenda periudhës gjashtëmujore nga nënshkrimi i kontratës të ketë përfunduar investimi për përmirësimin e objektit të qirasë në vlerën 5.000.000 (pesëmilion) lekë sipas zërave të pasqyruara në planbiznesin e paraqitur në konkurrim.
- Brenda kësaj periudhe (6-mujore) nga momenti i nënshkrimit të kontratës, qiramarrësi është i detyruar të instalojë makineritë dhe pajisjet që shërbejnë për realizimin e qëllimit të objektit të kontratës së qirasë, në vlerën 2,000,000 (dymilionë) lekë me destinacion realizimin e qëllimit për të cilën është marrë me qira objekti, sipas përshkrimit të kryer në planbiznesin e paraqitur në konkurrim dhe që është pjesë e kësaj kontrate.
5.8 "Qiramarrësi" me përfundimin e investimeve të përcaktuar në nenin 5.7 të kësaj kontrate është i detyruar të punësojë mesatarisht 55 vetë për të gjithë periudhën e kontratës së qirasë.
Qiramarrësi për realizimin e fazës së investimit si për përmirësimin e objektit të kontratës së qirasë dhe investimet në makineri e pajisje do të punësojë 10 veta, nga këto 7 për përmirësimin e objektit dhe 3 veta për instalimin e makinerive dhe pajisjeve.
"Qiramarrësi" detyrohet të zbatojë legjislacionin në fuqi "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi".
5.9 "Qiramarrësi", në funksion të qëllimit sipas nenit 2 dhe zhvillimit të aktivitetit, në territorin objekt i kësaj kontrate, në realizimin e treguesve të marrë përsipër sipas neneve 5.7 dhe 5.8 detyrohet që të pajiset me leje ndërtimi dhe leje mjedisore nga organet kompetente.
5.10 "Qiramarrësi" detyrohet të paguajë vlerën e qirasë prej 1 Euro për gjithë periudhën që është në fuqi kjo kontratë.
5.11 "Qiramarrësi" detyrohet të paraqesë te "Qiradhënësi" në fillim të çdo viti, relacion me shkrim lidhur me vlerat e investimeve, të paraqitura në pasqyrat financiare vjetore të subjektit, shoqëruar me relacionin përkatës të hartuar nga eksperti kontabël i miratuar, vërtetuar me çdo dokumentacion të vlefshëm, si dhe vërtetimin nga institucionet shtetërore përkatëse për numrin e të punësuarve në objektin e marrë me qira.
5.12 "Qiramarrësi" detyrohet që në momentin e përfundimit të kësaj kontrate të dorëzojë pronën të padëmtuar.
5.13 "Qiramarrësi", në përfundim të kësaj kontrate, ka të drejtë të heqë përmirësimet e ndashme nga prona, por pa e dëmtuar atë. "Qiradhënësi" nuk bën kompensimin financiar të investimeve në pasuri të paluajtshme të kryera nga "Qiramarrësi".
5.14 Në ngarkim të "Qiramarrësit" janë të gjitha tatimet dhe detyrimet që rëndojnë mbi pronën e dhënë me qira.
5.15 "Qiramarrësit" nuk i lejohet, që pronën e dhënë me qira ta japë me nënqira ose t'ia kalojë kontratën një tjetri.

5.16 "Qiramarrësi", në funksion të qëllimit dhe zhvillimit të aktivitetit sipas nenit 2 të kësaj kontrate, në territorin objekt i kësaj kontrate, në realizimin e treguesve të marrë përsipër, sipas neneve 5.7 dhe 5.8, detyrohet që të pajiset me lejet ose autorizimet përkatëse nga organet kompetente të parashikuara nga legjislacioni shqiptar.
5.17 "Qiramarrësi" në asnjë rast nuk mund ta rëndojë me barrë, pronën objekt kontrate.

NENI 6
PAGESA E QIRASË

6.1 "Qiramarrësi" detyrohet t'i paguajë "Qiradhënësit" detyrimin e kontratës në vlerën 1 (një) Euro, për gjithë periudhën që është në fuqi kjo kontratë.
6.2 Vlera e qirasë prej 1 Euro do të paguhet pas miratimit nga Këshilli i Ministrave, sipas faturës së lëshuar nga Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve pranë bashkisë, me emërtimin për periudhën _____2019 deri më _____ 2027 nga subjekti Shoqëria UNIERO shpk, me administrator zotin Arian Gjyzeli për pasurinë me nr. 2/423, ZK 8513, me sip.të përgjithshme 930 m^2 (nga kjo sip.ndërtimi 900 m^2 dhe sip.funksionale 30 m^2), pronë e bashkisë Durrës.
6.3 Para nënshkrimit të kontratës qiramarrësi është i detyruar të kryejë pagesën e garancisë së kontratës në masën 2 për qind të vlerës së investimit të marrë përsipër në konkurrim në vlerën 140.000 (njëqindedyzetëmijë) lekë, e cila qëndron e ngurtësuar deri në përfundim të kësaj kontrate qiraje.
6.4 Pagesa e qirasë fillon me marrjen në dorëzim të objektit të kontratës, por jo më vonë se një muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj kontrate.
6.5 Në rastet kur konstatohen parregullsi dhe zbatohen penalitete (gjoba dhe kamatëvonesa), "Qiramarrësi" do të likuidojë vlerat e krijuara në llogarinë e "Qiradhënësit", sipas faturës së lëshuar nga ky i fundit.

NENI 7
PENALITETET

7.1 Në rastin kur "Qiramarrësi", në përfundim të çdo faze, sipas përcaktimeve në pikën 5.7, të kësaj kontrate, nuk realizon vlerën e investimit, do të penalizohet me gjobë, në masën 10 për qind të vlerës së investimit të parealizuar. Nëse, pas 6 muajve, investimi vazhdon të mos realizohet, "Qiradhënësi" zgjidh kontratën dhe gjobit "Qiramarrësin" me vlerën e garancisë së ngurtësuar në momentin e lidhjes së kësaj marrëveshje kontraktore.
7.2 Në rastin kur, "Qiramarrësi", në përfundim të çdo faze, nuk ka realizuar nivelin e punësimit të përcaktuar në pikën 5.8, të kësaj kontrate, penalizohet me gjobë, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për çdo vend pune mesatar vjetor të pahapur.

NENI 8
ZGJIDHJA E KONTRATËS

8.1 Kontrata zgjidhet me mbarimin e afatit të përcaktuar në pikën 3 të kësaj kontrate.
8.2 Kontrata mund të zgjidhet para afatit:

a) në marrëveshje midis palëve;
b) kur prona humbet tërësisht ose dëmtohet për shkak të një force madhore;
c) kur "Qiramarrësi" shkel detyrimet e marra përsipër në nenet 5 dhe 6 të kësaj kontrate;
ç) kur 'Qiramarrësi" shkel detyrimet e marra përsipër në nenin 5.7 të kësaj kontrate;
d) kur prona nevojitet për interes publik;
dh) kur prona kalon në procedurë privatizimi.
8.3 Kontrata pushon automatikisht së vepruari 30 ditë pas njoftimit me shkrim të "Qiradhënësit" për zgjidhjen e kontratës para afatit, sipas pikës 8.2 të saj dhe nëse "Qiramarrësi" nuk ka reaguar me shkrim.

NENI 9
PËRGJEGJËSITË E PALËVE

9.1 Palët përgjigjen për mosrespektimin e kushteve të kësaj kontrate.
9.2 Në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, në përfundim të investimit, pas relacionit të paraqitur nga "Qiramarrësi", sipas pikave 5.7, 5.8 dhe 5.9, të kësaj kontrate, palët janë të detyruara të bëjnë akte rakordimi të përbashkëta ndërmjet administratorit të shoqërisë UNIEURO dhe bashkisë Durrës si pronare e pasurisë objekt i kontratës së qirasë, për nivelin e investimeve dhe punësimit të realizuar, sipas vlerave të paraqitura në pasqyrat financiare të subjektit, shoqëruar me relacionin përkatës të hartuar nga eksperti kontabël i miratuar.
9.3 "Qiramarrësi" dhe "Qiradhënësi", janë të detyruar që çdo vit të bëjnë akte rakordimi të përbashkëta për realizimin e kushteve të kontratës, në nivelin e punësimit, në nivelin e investimit dhe shlyerjen e penaliteteve ose gjobave (në rastet kur ka të tilla) të vendosura, sipas neneve të kësaj kontrate.
9.4 Me "forcë madhore" do të kuptohet një ngjarje që është jashtë kontrollit të palëve, si: tërmetet, përmbytjet, lufta. Në këto raste palët janë të detyruara të njoftojnë njëra-tjetrën me shkrim. Koha e parashikuar për plotësimin e detyrimeve do të zgjatet për aq kohë sa do të vazhdojnë këto rrethana.
9.5 "Qiramarrësi" përjashtohet nga detyrimet për kohën e vazhdimit të forcës madhore dhe mos kryerjes së aktivitetit për këtë shkak. Kjo periudhë do të përcaktohet me marrëveshje midis palëve.

NENI 10
DISPOZITA TË FUNDIT

10.1 Për gjithçka që nuk është shprehur posaçërisht në këtë kontratë, palët do t'u referohen dispozitave të Kodit Civil në fuqi.
10.2 Pjesë të kësaj kontrate janë planbiznesi i paraqitur para komisionit të konkurrimit dhe procesverbali i marrjes në dorëzimi të objektit, sipas kontratës së qirasë.
10.3 Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes palëve gjatë zbatimit të kësaj kontrate do të zgjidhen me mirëkuptim dhe në rast se kjo është e pamundur, palët kanë të drejtë t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor .
10.4 Në çdo rast të kalimit të mosmarrëveshjeve, të lindura mes palëve në juridiksion gjyqësor, autorizohet njësia administruese dhe monitoruese e kontratës (Drejtoria Ligjore) për ndjekjen e procedurës gjyqësore.

10.5 Kjo kontratë qiraje është e vlefshme deri në çastin, që prona publike e dhënë me qira privatizohet sipas akteve ligjore në fuqi.

NENI 11

Brenda një muaji, nga nënshkrimi i saj, kontrata duhet të regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Shpenzimet që rrjedhin nga pagesa e tarifave në ZVRPP-në Durrës i ngarkohen "Qiramarrësit".
Shpenzimet noteriale të kësaj kontrate i ngarkohen "Qiramarrësit".

QIRAMARRËSI
Arian Gjyzeli

QIRADHËNËSI
KRYETARI I BASHKISË DURRËS
Vangjush Dako

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA DURRËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

ÇERTIFIKATË 1408713

PËR VËRTETIM PRONËSIE

Zyra e Regjistrimit DURRES Zona Kadastrale Nr. 8513

Numri i Pasurisë 2/423 Volumi 28 Faqe 140

Adresa e Pasurisë P. HANXHARI/17

Lloji i Pasurisë TRUALL

Sipërfaqja Totale 8767,87m2

Nga kjo : Sa Truall 8767,87m2 Nga kjo : Sa Ndërtesa 3204m2

Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes — %

KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti (Zotërinjtë)

Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa	Adresa
BASHKIA	DURRES		I	DURRES

- është pronar i 2/423
- janë bashkëpronarë sipas pjeseve më lart —
- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi —
- kufizimet e pasurisë janë : V —, L —, J —, P —

Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë ____ Nr. ____

Data e lëshimit të çertifikatës

30.05.2016.


HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT
YRA VENDORE E REGJISTRIMIT TE PASURIVE TE PALUAJTSHME
DURRES
A. IDENTIFIKIMI I PASURISE
ZONA KADASTRALE 8513 NR.PASURISE 2/421 VOL. 28 FQ.140
INDEKSI I HARTES DR; H. I - 6, 7 SHKALLA 1:1000
ADRESA E PASURISE : Rrethi Durres Q/T DURRES
Rr/L P. HANXHARI / 17
REGJISTRUESI I RRETHIT
ANI DARMISHI
B. KUFIZIME
V. PASURIA Nr
L. PASURIA Nr
J. PASURIA Nr
P. PASURIA Nr
C. PRONARI
"BASHKIA DURRES"
Data 25 / 05 / 2016 Ora 12:00
REPUBLIKA E SHQIPERISE
ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TE PASURIVE TE PALUAJTSHME
V.R.P.P. DURRES
RR. PJETER HANXHARI
2/417
2/416
2/415
2/414
2/421
2/405
2/396
2/455
2/505
2/506
2/427
2/428
2/429
2/705
2/697
2/531
2/610
2/611
2/613
2/612
2/749
2/606
2/607
2/619
2/620
2/623
2/500
2/757
2/651
2/627
ND1
ND2


ISH NDERMARRJA U.R.T - DURRES
Planimetria e katit pare(Ish Ndermarja U.R.T)
dhe siperfaqja e destinuar per qeradhenie
SH 1:500
Planvendosja e Ambientit
SH 1:1000
MIRATOHET
DREJTORI I DREJTORISE PLANIFIKIMIT DHE KONTROLLIT TE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT
SEKTORI I KADASTRES/HARTOGRAFISE DHE MENAXHIMIT TE QEOINFORMACIONIT
SEKTORI I PRONAVE DHE MENAXHIMIT TE ASETEVE
SPECIALISTI
S 3
S 2
S 1
Reparte pune
2kt
Administrata 2kt
1kt
sip.e destinuar per qeradhenie
(fragment ambienlesh ne katin pare)
siperfaqja e ndertuar 300 m2

VENDIM
Nr. 508, datë 17.7.2019

PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR LIDHJEN E KONTRATËS SË QIRASË ME TARIFËN 1 EURO/KONTRATA, NDËRMJET MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË, SI QIRADHËNËS, DHE SHOQËRISË "BLU-IMPERIAL", SHPK, SI QIRAMARRËS, PËR PASURINË NR. 94, ME EMËRTIMIN "ISH-GRUP DEPOT E REPARTIT USHTARAK NR. 4025", ME VENDNDODHJE NË QAFËMOLLË, DAJT, TIRANË, NË ADMINISTRIM TË MINISTRISË SË MBROJTJES

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të aktit normativ me fuqinë e ligjit nr. 4, datë 9.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve", miratuar me ligjin nr. 9967, datë 24.7.2008, të ndryshuar, dhe të vendimit nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si qiradhënës, dhe shoqërisë "Blu-Imperial" sh.p.k., si qiramarrës, për pasurinë nr. 94, me emërtimin "Ish-Grup Depot e Repartit Ushtarak nr. 4025", me sipërfaqe të përgjithshme 353 686 (treqind e pesëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e gjashtë) m^2, nga ku, sipërfaqe nën objekt 8 553.58 (tetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e tre pikë pesëdhjetë e tetë) m^2, tunele (5 tunele), me sipërfaqe 3 434.6 (tre mijë e katërqind e tridhjetë e katër pikë gjashtë) m^2, dhe sipërfaqe funksionale 341 697.82 (treqind e dyzet e një mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e shtatë pikë tetëdhjetë e dy) m^2, zk.3081, me vendndodhje në Qafëmollë, Dajt, Tiranë, në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes, për një periudhë 20 (njëzet) vjet, sipas genplanit dhe tekstit të projektkontratës bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E NOTERISË TIRANË
Nr._____Rep.
Nr._____Kol.

DRAFTKONTRATË QIRAJE
Me çmimin simbolik 1 euro/kontrata
Lidhur

Në Tiranë, sot më datë _____, të muajit _____ të vitit 2019 (dymijë e nëntëmbëdhjetë), u paraqitën para meje noterit_____, palët kontraktuese si më poshtë vijon:

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përfaqësuar me autorizim të Ministrit, nr. _____ nga Z./Znj. _____ me detyrë _____, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, i datëlindjes __/__/_____, banues në _____, me shtetësi shqiptare i/e pajisur me letër njoftimin nr. _____, që më poshtë do të quhet **"QIRADHËNËSI",**

DHE

Shoqëria "Blu Imperial" sh.p.k., me seli qendrore në Tiranë, me adresë, Komuna Qafëmollë" Tiranë, regjistruar si person juridik dhe pajisur nga QKB-ja, me NIPT: J61909041K, përfaqësuar nga administratori i shoqërisë z. Haredin Kastrati,me shtetësi shqiptare, identifikuar me letër njoftimi personal me nr. H30525204K që më poshtë do të quhet "QIRAMARRËSI".

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, mbështetur në vendimin nr. 54, datë 5.2.2014 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kritereve,

të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore", të ndryshuar, në zbatim të vendimit nr. ____, datë __.__.____ të Këshillit të Ministrave "Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 Euro/kontrata", ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si Qiradhënës dhe Shoqërisë "Blu Imperial" sh.p.k. si Qiramarrës, për pasurinë shtetërore nr. 94, me emërtimin "Ish-Grup Depot e Repartit Ushtarak nr. 4025" me sipërfaqe të përgjithshme 353 686 m^2, nga ku sipërfaqe nën objekt 8553.58 m^2, tunele (5 tunele) me sipërfaqe 3434.6 m^2, dhe sipërfaqe funksionale 341 697,82 m^2, Zk. 3081", me vendndodhje Qafëmollë, Dajt, Tiranë, në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes, dhe bazuar në nenet 801–825 të Kodit Civil, së bashku me "Qiramarrësin", palët bien dakord të hartojnë këtë kontratë, me kushtet si më poshtë:

Neni 1
Objekti i kontratës

Objekti i kësaj kontrate, është dhënia me qira e pasurisë shtetërore nr. 94, me emërtimin "Ish-Grup Depot e Repartit Ushtarak nr. 4025" me sipërfaqe të përgjithshme 353 686 m^2, nga ku sipërfaqe nën objekt 8553.58 m^2, tunele (5 tunele) me sipërfaqe 3434.6 m^2, dhe sipërfaqe funksionale 341 697,82 m^2, Zk. 3081", me vendndodhje Qafëmollë, Dajt, Tiranë, në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes,sipas genplanit dhe dokumentit të ZVRPP Tiranë.

Neni 2
Qëllimi i përdorimit

Qëllimi i kësaj kontrate është dhënia në gëzim të përkohshëm i objektit të përcaktuar në nenin 1, për ndërtimin e një kapanoni, brenda së cilës do të montohen dy linja të reja, për mbushjen e ujit mineral të gazuar dhe të pa gazuar në shishe PET, me shishe qelqi të kthyeshme dhe të pa kthyeshme, filtrimin hidrogjenik UF ULTRA FILTRATION për produktin ujë.

Neni 3
Kohëzgjatja

Kjo kontratë është e vlefshme për një periudhe 20 (njëzetë) vjet dhe hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët.

Neni 4
Të drejtat dhe detyrimet e qiradhënësit

4.1 "Qiradhënësi", nëpërmjet Komandës Mbështetëse si njësia që ka në administrim pasurinë shtetërore, dorëzon brenda një muaji nga hyrja në fuqi e kësaj kontrate, pronën e përcaktuar në nenin 1 të saj, të lirë për t'u shfrytëzuar për qëllimin e kësaj kontrate. Në momentin e dorëzimit do të hartohet proces-verbali i dorëzimit të objektit që jepet me qira i shoqëruar me foto, i cili është pjesë përbërëse e kontratës.

4.2 "Qiradhënësi" ka të drejtë të kontrollojë në çdo kohë për respektimin e kushteve të kësaj kontrate nga ana e "Qiramarrësit".

4.3 "Qiradhënësi" ka të drejtë që, në çdo kohë gjatë kohëzgjatjes së kontratës, nëpërmjet njësisë monitoruese të kontratës së qirasë, Komandës Mbështetëse, strukturë e Ministrisë së Mbrojtjes, të monitorojë kontratën për verifikimin e zbatimit të kushteve të përcaktuara në të.

4.4 "Qiradhënësi" është i detyruar të garantojë "Qiramarrësin" për gëzimin e qetë të sendit, objekt të kësaj kontrate ndaj të tretëve, të cilët mund të ngrenë pretendime për të drejtën e tyre mbi këtë pronë.

4.5 "Qiradhënësi" ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës kur Qiramarrësi shkel detyrimet e marra përsipër, duke njoftuar këtë të fundit 30 ditë përpara me shkrim.

4.6 "Qiradhënësi" nuk është i detyruar të garantojë Qiramarrësin nga shqetësimet e të tretëve që nuk pretendojnë të kenë të drejta mbi pronën.

Neni 5
Të drejtat dhe detyrimet e qiramarrësit

5.1 "Qiramarrësi" ka të drejtë që, sipas legjislacionit në fuqi, të përdorë e të gëzojë pronën e marrë me qira dhe përmirësimet e bëra në të, për gjithë kohën që është në fuqi kjo kontratë.

5.2 "Qiramarrësi" ka për detyrë që të përdorë sendin, objekt të kësaj kontrate, për qëllimin e

parashikuar në nenin 2, në përputhje me detyrimet ligjore që rrjedhin nga Legjislacioni Shqiptar për mjedisin dhe konventat ndërkombëtare për mjedisin në të cilat aderon Republika e Shqipërisë.

5.3 "Qiramarrësi" detyrohet që, në pasurinë e marrë me qira, të realizojë aktivitetin sipas nenit 2 të kësaj kontrate, duke investuar sipas fazave dhe vlerave të shprehura në plan biznesin e paraqitur në komisionin e vlerësimit të dokumenteve.

5.4 "Qiramarrësi" detyrohet të shfrytëzojë dhe të mirëmbajë objektin e kontratës së qirasë.

5.5 "Qiramarrësi" detyrohet të përballojë me shpenzimet e tij, detyrimet që lidhen me dëmet e shkaktuara eventualisht palëve të treta.

5.6 "Qiramarrësi" detyrohet të sigurojë objektin e kontratës së qirasë, nëpërmjet policës së sigurimit.

5.7 "Qiramarrësi", Shoqëria "Blu Imperial" sh.p.k., sipas planbiznesit të paraqitur në konkurrim do të investojë në ndërtimin e një kapanoni, brenda së cilës do të montohen dy linja të reja, për mbushjen e ujit mineral të gazuar dhe të pa gazuar në shishe PET, me shishe qelqi të kthyeshme dhe të pa kthyeshme, filtrimin hidrogjenik UF ULTRA FILTRATION për produktin ujë.

Shoqëria "BLU-IMPERIAL" sh.p.k., në pasurinë shtetërore të sipërcituar, do të investojë brenda vitit 2020 një total prej 942 346 300 lekë, i ndarë si më poshtë shënuar:

- Blerja e dy linjave të reja të prodhimit për mbushjen e ujit mineral të gazuar dhe të pa gazuar në shishe PET, me shishe qelqi të kthyeshme dhe të pa kthyeshme, filtrimin hidrogjenik UF ULTRA FILTRATION për produktin ujë, nëpërmjet kontratës së lidhur me kompaninë gjermane "KRONES AG", në vlerën 756 601 300 lekë;

- Ndërtimi i magazinave të reja në vlerën 123 830 000 lekë;

- Blerja e makinave për shpërndarjen e ujit në 12 qarqet e vendit në vlerën 61 950 000 lekë;

Shoqëria, nga data e marrjes në dorëzim të objektit dhe nxjerrjes së lejeve përkatëse, brenda vitit 2020 do të investojë në total prej 942 346 300 lekë (pa TVSH) nëntëqind e dyzet e dy milion e treqind e dyzet e gjashtë mijë e treqind) lekë.

Pavarësisht parashikimeve të realizimit si më sipër, monitorimi dhe përllogaritjet e afateve të realizimeve të investimeve të parashikuara transferohen në kohë gjithmonë pas datës së lejeve përkatëse të nevojshme për punime, ngritjen e aktivitetit dhe vënien në jetë të tij.

5.8 "Qiramarrësi", sipas plan biznesit të paraqitur në konkurrim, me përfundimin e investimit, nga data e marrjes në dorëzim të objektit dhe nxjerrjes së lejeve përkatëse, merr përsipër që, brenda vitit 2020 do të punësojë 50 (pesëdhjetë) punonjës të rinj, numër i cili do të rritet në varësi të ecurisë së prodhimit. Në vijim të zhvillimit të kontratës numri i të punësuarve nuk do të jetë më pak se 50 (pesëdhjetë) punonjës me kohë të plotë dhe të siguruar pranë institucioneve përkatëse.

Pavarësisht parashikimeve të realizimit si më sipër, monitorimi dhe përllogaritjet e afateve të realizimeve të punësimit të parashikuar transferohen në kohë gjithmonë pas datës së lejeve përkatëse të nevojshme për punime, ngritjen e aktivitetit dhe vënien në jetë të tij.

5.9 "Qiramarrësi" detyrohet të zbatojë legjislacionin në fuqi "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi".

5.10 "Qiramarrësi", në funksion të qëllimit dhe zhvillimit të aktivitetit, sipas nenit 2 në territorin objekt i kësaj kontrate, në realizimin e treguesve të marrë përsipër sipas neneve 5.7 dhe 5.8, detyrohet që të pajiset me leje ndërtimi dhe leje mjedisore nga organet kompetente.

5.11 "Qiramarrësi" detyrohet që, para përfundimit të vitit të pestë të përdorimit të objektit me qira sipas kësaj kontrate, të paraqesë para Qiradhënësit shtesën e plan biznesit për treguesit e periudhës në vijim, brenda objektit të kontratës dhe pa ulur treguesit e shprehur në pikat 5.7 dhe 5.8 të kësaj kontrate.

5.12 "Qiramarrësi" detyrohet që nëpërmjet Komandës Mbështetëse, të paraqesë tek "Qiradhënësi" në fillim të çdo viti, relacion me shkrim lidhur me vlerat e investimeve, të paraqitura në pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë shoqëruar me relacionin përkatës të hartuar nga eksperti kontabël i miratuar, vërtetuar me çdo dokumentacion të vlefshëm, si dhe vërtetimin nga institucionet shtetërore përkatëse për numrin e të punësuarve në objektin e marrë me qira.

5.13 "Qiramarrësi" detyrohet që në momentin e përfundimit të kësaj kontrate të dorëzojë pronën të padëmtuar.

5.14 "Qiramarrësi", në përfundim të kësaj kontrate, ka të drejtë të heqë përmirësimet e ndashme nga prona, por pa dëmtuar atë. "Qiradhënësi" nuk bën kompensimin financiar të

investimeve në pasuri të paluajtshme të kryera nga "Qiramarrësi".

5.15 Në ngarkim të "Qiramarrësit" janë të gjitha tatimet dhe detyrimet që rëndojnë mbi pronën e dhënë me qira.

5.16 "Qiramarrësit" nuk i lejohet, që pronën e dhënë me qira ta japë me nën qira ose t'ia kalojë kontratën një tjetri.

5.17 "Qiramarrësi", në funksion të qëllimit dhe zhvillimit të aktivitetit sipas nenit 2 të kësaj kontrate, në territorin objekt i kësaj kontrate, në realizimin e treguesve të marrë përsipër, sipas neneve 5.7 dhe 5.8, detyrohet që, të pajiset me Lejet ose Autorizimet përkatëse nga organet kompetente të parashikuara nga legjislacioni shqiptar.

5.18 "Qiramarrësi" në asnjë rast nuk mund ta rëndojë me barrë, pronën objekt kontrate.

5.19 Shitja e kuotave të aksioneve apo ndryshimi i ortakëve të shoqërisë qiramarrëse, do të kryhet vetëm pas miratimit paraprak të "qiradhënësit".

Neni 6
Pagesa e qirasë

6.1 "Qiramarrësi" detyrohet t'i paguajë "Qiradhënësit" detyrimin e kontratës, në vlerën 1 (një) Euro. Pagesa simbolike bëhet para se të firmoset kontrata.

6.2 Para nënshkrimit të kontratës "Qiramarrësi" ka paguar garancinë e kontratës, në vlerën 18.846.926 (tetëmbëdhjetë milion e tetëqind e dyzet e gjashtë mijë e nëntëqind e njëzet e gjashtë) lekë, sipas faturës së lëshuar nga "Qiradhënësi", e cila qëndron e ngurtësuar, në llogarinë përkatëse në buxhetin e shtetit, deri në përfundim të investimit të shprehur në nenin 5.7 të kësaj kontrate.

6.3 Në rastet kur konstatohen parregullsi dhe zbatohen penalitete ose gjoba, "Qiramarrësi" do të likuidojë vlerat e krijuara në llogarinë e "Qiradhënësit" sipas faturës së lëshuar nga ky i fundit.

Neni 7
Penalitetet

7.1 Në rastin kur "Qiramarrësi", në përfundim të çdo faze, sipas përcaktimeve në pikën 5.7, të kësaj kontrate, nuk realizon vlerën e investimit, do të penalizohet me gjobë, në masën 10 për qind të vlerës së investimit të parealizuar. Nëse, pas 6 muajve, investimi vazhdon të mos realizohet, "Qiradhënësi" zgjidh kontratën dhe gjobit "Qiramarrësin" me vlerën e garancisë së ngurtësuar në në momentin e lidhjes së kësaj marrëveshje kontraktore.

7.2 Në rastin kur, "Qiramarrësi", në përfundim të çdo faze, nuk ka realizuar nivelin e punësimit të përcaktuar në pikën 5.8, të kësaj kontrate, penalizohet me gjobë, në masën 50.000 (pesëdhjetëmijë) lekë për çdo vend pune mesatar vjetor të pahapur.

Neni 8
Zgjidhja e kontratës

8.1 Kontrata zgjidhet me mbarimin e afatit të përcaktuar në pikën 3 të kësaj kontrate.

8.2 Kontrata mund të zgjidhet para afatit:

a) në marrëveshje midis palëve.

b) kur prona humbet tërësisht ose dëmtohet për shkak të një force madhore.

c) kur "Qiramarrësi" shkel detyrimet e marra përsipër në nenin 5 dhe 6 të kësaj kontrate.

d) kur "Qiramarrësi" ndryshon destinacionin për të cilin është lidhur kontrata.

e) kur prona nevojitet për interes publik.

f) kur prona kalon në procedurë privatizimi.

8.3 Kontrata pushon automatikisht së vepruari, 30 ditë pas njoftimit me shkrim të "Qiradhënësit" për zgjidhjen e kontratës para afatit, sipas pikës 8.2 të saj dhe nëse "Qiramarrësi" nuk ka reaguar me shkrim.

Neni 9
Përgjegjësitë e palëve

9.1 Palët përgjigjen për mosrespektimin e kushteve të kësaj kontrate.

9.2 Në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, në përfundim të investimit, pas relacionit të paraqitur nga "Qiramarrësi", sipas pikave 5.7, dhe 5.8 të kësaj kontrate, palët janë të detyruar të bëjnë akte rakordimi të përbashkëta ndërmjet administratorit të pasurisë, Komandës Mbështetëse, për nivelin e investimeve dhe punësimit të realizuara, sipas vlerave të paraqitura në pasqyrat financiare të Shoqërisë shoqëruar me

relacionin përkatës të hartuar nga eksperti kontabël i miratuar.

9.3 Palët, "Qiramarrësi" dhe Komanda Mbështetëse, janë të detyruar që çdo vit të bëjnë akte rakordimi të përbashkëta për realizimin e kushteve të kontratës, në nivelin e punësimit, në nivelin e investimit dhe shlyerjen e penaliteteve ose gjobave (në rastet kur ka të tilla) të vendosura, sipas neneve të kësaj kontrate.

9.4 Me "Forcë Madhore" do të kuptohet një ngjarje që është jashtë kontrollit të palëve, si tërmetet, përmbytjet, lufta. Në këto raste palët janë të detyruara të njoftojnë njëra tjetrën me shkrim. Koha e parashikuar për plotësimin e detyrimeve do të zgjatet për aq kohë sa do të vazhdojnë këto rrethana.

9.5 "Qiramarrësi" përjashtohet nga detyrimet për kohën e vazhdimit të Forcës Madhore dhe mos kryerjes së aktivitetit për këtë shkak. Kjo periudhë do të përcaktohet me marrëveshje midis palëve.

Neni 10
Dispozitat e fundit

10.1 Për gjithçka që nuk është shprehur posaçërisht në këtë kontratë, palët do t'i referohen dispozitave të Kodit Civil në fuqi.

10.2 Pjesë të kësaj kontrate janë Plan biznesi i paraqitur para komisionit të konkurrimit dhe proces verbali i marrjes në dorëzimi të objektit, sipas kontratës së qirasë.

10.3 Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes palëve gjatë zbatimit të kësaj kontrate do të zgjidhen me mirëkuptim dhe në rast se kjo është e pamundur, palët kanë të drejtë t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor.

10.4 Në çdo rast të kalimit të mosmarrëveshjeve, të lindura mes palëve në juridiksion gjyqësor, autorizohet njësia administruese dhe monitoruese e kontratës për ndjekjen e procedurës gjyqësore.

10.5 Kjo kontratë qiraje është e vlefshme deri në çastin, që prona publike e dhënë me qira privatizohet sipas akteve ligjore në fuqi.

Neni 11

Brenda një muaji nga nënshkrimi i saj, kontrata duhet të regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Shpenzimet noteriale të kësaj kontrate i ngarkohen "Qiramarrësit".

Kjo kontratë është formuluar në shtatë kopje origjinale. Pasi ju lexua palëve, u kuptua, u pranua prej tyre, si dhe u nënshkrua para meje me vullnetin e tyre të plotë e të lirë. Ndërsa, unë noter _____, në bazë te nenit 801 e vijim të Kodit Civil, e vërtetoj atë si të rregullt.

QIRADHËNËSI
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Përfaqësuar nga:

QIRAMARRËSI
Shoqëria "Blu Imperial" sh.p.k.
Përfaqësuar nga



HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT
(Fragment)

IDORE E REGJISTRIMIT
IVE TË PALUAJTSHME
TIRANË

REGJISTRUES

A.IDENTIFIKIMI I PASURISË
ZONA KADASTRALE 3084 NR.PASURISË 3236 VOL. 3 FQ. 90
INDEKSI I HARTËS K-34-88-(239-C;255-A) SHKALLA 1:2500
ADRESA E PASURISË: Rrethi: TIRANË, Q/F GRF MOLLE
Rr/L_____,P/G_____,Sh_____,K_____, Ap____

B.KUFIZIMET
V.
L. 3236
J.
P.

C. PRONARI
REPUBLIKA E SHQIPERISE


GEN PLAN
Prona nr.94 "Grup depo të rep. usht.nr.4025"Qafe Molle, Tiranë
MIRATOHET
Komandanti i Komandes Mbështetëse
Kolonel GASPËR LALA
ZV/DREJTORI I IGJIU
Ark. ENEA SINOIMERI
Hartoi
Topograf Ramiz Haxhiu
IDENTIFIKIMI I PASURISE
Zona Kadastrale 3081,3348
Nr.Pasurise Vol. Fq
Indeksi i Hartes K-34-88- (239-C),K-34-88-(255-A)
Shkalla 1: 3000
Adresa e pasurise,Tiranë
Q/F Qafe Molle, Tiranë
Pronari :
Ministria e Mbrojtjes, Komanda Mbështetëse
Shkurt 2019
Shpjeguese
Sip. e përgj. = 353 686.00m2
Sip. e përgj. nën objekte = 8 553.58m2
Kufiri i pronës
Objektet e Pronës nr.94
Sip. e objektit nr.1 = 201.75 m²
Sip. e objektit nr.2 = 24.5 m²
Sip. e objektit nr.3 = 192.0 m²
Sip. e objektit nr.4 = 372.07 m²
Sip. e objektit nr.5 = 372.07 m²
Sip. e objektit nr.6 = 192.00 m²
Sip. e objektit nr.7 = 56.04 m²
Sip. e objektit nr.8 = 379.44 m²
Sip. e objektit nr.9 = 335.26 m²
Sip. e objektit nr.10 = 68.97 m²
Sip. e objektit nr.11 = 192.00 m²
Sip. e objektit nr.12 = 360.00 m²
Sip. e objektit nr.13 = 437.40 m²
Sip. e objektit nr.14 = 374.40 m²
Sip. e objektit nr.15 = 406.00 m²
Sip. e objektit nr.16 = 362.00 m²
Sip. e objektit nr.17 = 362.00 m²
Sip. e objektit nr.18 = 379.44 m²
Sip. e objektit nr.19 = 156.20m²
Sip. e objektit nr.20 = 309.88 m²
Sip. e objektit nr.21 = 379.44 m²
Sip. e objektit nr.22 = 434.00 m²
Sip. e objektit nr.23 = 197.62 m²
Sip. e objektit nr.24 = 113.30 m²
Sip. e objektit nr.25 = 333.27 m²
Sip. e objektit nr.26 = 403.20 m²
Sip. e objektit nr.27 = 403.20m²
Sip. e objektit nr.28 = 167.66 m²
Sip. e objektit nr.29 = 333.27 m²
Sip. e objektit nr.30 = 200.50 m²
Sip. e objektit nr.31 = 54.70 m²
Sip. e përgj. nën objekte = 8 553.58m2
Sip. e tunelit nr.1 = 869.2 m²
Sip. e tunelit nr.2 = 547.2m²
Sip. e tunelit nr.3 = 584.0 m²
Sip. e tunelit nr.4 = 576.7 m²
Sip. e tunelit nr.5 = 857.5 m²
Sip. e përgj. e tuneleve = 3434.6 m²
Tuneli Nr.1
Tuneli Nr.2
Tuneli Nr.3
Tuneli Nr.4
Tuneli Nr.5
PIK. KARBURANTI
Shënim: Ky genplan u hartua në zbatim të shkresës së Komandes Mbështetëse nr.786/1, datë 08.02.2019, bazuar në dokumantacionin hartografik të pronës me nr.94 me emërtimin "Grup depo të tep. usht. 4025" me vendndodhje Qafë Mollë 1, Tiranë, marrë në arkivin e IGJIU.

REPUBLIKA ESHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
ZYRA QËNDRORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME
ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME TIRANË

Nr 5374 **Prot** **Tiranë, më** 12.02.**2019**

Lënda : **Kthim pergjigje**

Drejtuar: **MINISTRIA E MBROJTJES**
SHTABI I PERGJITHSHEM I FORCAVE TE ARMATOSURA
KOMANDA MBESHTETESE

Ne pergjigje te shkreses suaj nr 785/2 prot. date 08/02/2019, protokolluar ne Zvrpp nr 5374 prot date 12/02/2019, me ane te se ciles kerkoni konfirmim te gjendjes juridike te pasurive te konturuara ne planvendosjen bashkelidhur shkreses cituar me siper, ju bejme me dije se bashkelidhur do te gjeni kopje kartele dhe kopje te fragmentit te hartes kadastrale te prones Nr. 94 "Qafe Molle 1", Dajt Tirane.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

REGJISTRUES
ELION SEMANAJ
Me Urdher dhe Delegim Kryeregjistrues i Sektorit
ELIANA NEZHA

Z.V.R.P.P TIRANË

Rr. "Jordan Misja" Tiranë
http:/www.zrpp.gov.al
Tel: - 35542403302
Faks: - 35542403306

94

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

ÇERTIFIKATË 1464155

PËR VËRTETIM PRONËSIE

Zyra e Regjistrimit Z.V.R.P.P. TIRANË Zona Kadastrale Nr. 3081

Numri i Pasurisë 3236 Volumi 3 Faqe 90

Adresa e Pasurisë QAFE MOLLE

Lloji i Pasurisë TRUALL

Sipërfaqja Totale 353686.00 m2

Nga kjo : Sa Truall 353,686.00 Nga kjo : Sa Ndërtesa 8,210.80

Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes ____ %

KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti (Zotërinjtë)

Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa	Adresa
REPUBLIKA E SHQIPERISE			1/1	TIRANE

- është pronar i pasurisë me numër 3236
- janë bashkëpronarë sipas pjeseve më lart
- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi
- kufizimet e pasurisë janë : V ____, L ____, J ____, P ____

Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë 28/5/2018 HERISI Nr.52174

Data e lëshimit të çertifikatës

3 7/2018

Lëshuesi i certifikatës

REGJISTRUESI

ELIDA SEMANAJ

Miratuar nga V. K. M. Nr. 519, Datë 7.11.1994

KARTELA E PASURISE SE PALUAJTSHME

Vol 3 Fq 90

A - SEKSIONI I IDENTIFIKIMIT TE PASURISE

Vijon nga Vol ... Fq ...

Zona Kadastrale 3081 NR.i PASURISE 3236

Vijon në Vol ... Fq ... deri në Vol ... Fq ...

Indeksi i Hartes K-34-88(239-C)(255

Adresa e Pasurisë: Rrethi TIRANË Q/T OAFE MOLLE

PERFUNDIMTARE (data): ...

Rr/L ... P/G ... SH ... K ... Ap ...

Përshkrim i vecantë

GRUP DEPO REP.USHT. HR 4025
NE PERGJEGJESI ADMINISTRIMI TE MINISTRISE SE MBROJTJES

B - SEKSIONI I PERSHKRIMIT TE PASURISE

Lloji i Pasurisë: TRUALL Brenda V.K.N PO , Ref PL.

RREGULLUES

Sip. Totale e Pasurisë	Nga Sip. Totale sa Trual	Nga Sip. Truall sa Ndërtesë
1. 353,686.00 m² Ref. 00000075	1. 353,686.00 m² Ref 00000075	1. 8,210.80 m² Ref. 00000075
2. ... m² Ref. ...	2. ... m² Ref. ...	2. ... m² Ref. ...
3. ... m² Ref. ...	3. ... m² Ref. ...	3. ... m² Ref. ...
4. ... m² Ref. ...	4. ... m² Ref. ...	4. ... m² Ref. ...

Per pjesen e përbashkët:

PALLAT

Kuota e pjesmarrjes: ... %

Nr i Pasurise (pallat)

Vol. ... Faqe ...

REPUBLIKA E SHQIPERISE ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURIVE Z.V.R.P.P. TIRANË

C - SEKSIONI I PRONESISE

Nr.Dok	Data Regjistrimit	Emri Atesia Mbiemri	Nr. Pasap	I/F/B	Adresa e Pronarit	Shuma e Paguar	Data e Lësh. Certifikatës	Shënime	Firma
00000075	03/07/2018	REPUBLIKA E SHQIPERISE		I	TIRANË		03/07/2018	V.KM	

Shënim Kollona I F B tregon I - individ, person fizik ose juridik F - përfaqesues i familjes, B - bashkëpronar (*e)

D - SEKSIONI I QIRAVE, NE PERDORIM, MARREVESHJEVE KUFIZUESE, SERVITUTAVE DHE INTERESAVE TE TJERA

Nr Dok	Data Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lësh Certifikatës	Shënime	Firma
00000175	03/07/2018	RF2	PASURIA NE PERGJEGJESI ADMINISTRIMI TE MINISTRISE SE MBROJTJES			

E - SEKSIONI I HIPOTEKAVE, VENDIMEVE TE GJYKATES, KUFIZIMEVE, etj

Nr Dok	Data Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lësh Certifikatës	Shënime	Firma

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
ZYRA QËNDRORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME
ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME TIRANË
Adresa: Rruga Jordan Misja, Tirane

TIRANË, me 19 / 2 / 2019

SHËNIM: Kjo kopje kartele në A4, ka fuqi të njëjtë me origjinalin e ndodhur në zyrën tonë

Në regjistrin Vol 3 , Faqe 90 , Zona Kadastrale 3081 , Qyteti Tirane

REGJISTRUESI
ELION SEMANJ

ZVRPP TIRANË

VENDIM
Nr. 509, datë 17.7.2019

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 551, DATË 18.6.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E KRITEREVE DHE TË PROCEDURAVE PËR PAJISJEN ME CERTIFIKATËN E LEJES PROFESIONALE PËR VEPRIMTARITË STUDIMORE-PROJEKTUESE DHE ZBATUESE PËR KËRKIMIN, PRODHIMIN, PËRPUNIMIN, TRANSPORTIMIN, DEPOZITIMIN DHE TREGTIMIN E LËNDËVE HIDROKARBURE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 5, dhe 115, pika 4, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 551, datë 18.6.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"6. Personi juridik ose fizik, për të ushtruar veprimtarinë studimore-projektuese dhe/ose zbatuese në fushën e veprimtarisë hidrokarbure, duhet ta ketë të regjistruar si objekt, në regjistrin tregtar, kryerjen e kësaj veprimtarie.".

b) Pika 7 shfuqizohet;

c) Pika 8 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"8. Personi juridik ose fizik, i regjistruar paraprakisht në regjistrin tregtar, që ushtron veprimtarinë studimore-projektuese dhe/ose zbatuese në fushën e veprimtarisë hidrokarbure, duhet të ketë të punësuar specialistë, të cilët të jenë të pajisur me certifikatë, sipas kategorisë përkatëse, për veprimtari studimore-projektuese dhe/ose zbatuese në fushën e veprimtarisë hidrokarbure.".

2. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 510, datë 17.7.2019

PËR KALIMIN NË PRONËSI, TË BASHKISË TIRANË, TË DISA PASURIVE TË PALUAJTSHME NË ZONËN KADASTRALE 3292 (KOPSHTI BOTANIK) DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 430, DATË 2.7.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI UNIVERSITETIT TË TIRANËS", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, shkronja "d", 5, 8 e 17, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi të Bashkisë Tiranë të disa pasurive të paluajtshme me vendndodhje në zonën kadastrale 3292 (Kopshti Botanik), Tiranë, për t'i përdorur për ushtrimin e funksioneve të veta, sipas shtojcës nr. 1 dhe kartelave të pasurive që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Bashkia Tiranë dhe Universiteti i Tiranës lidhin një marrëveshje me qëllim garantimin e ushtrimit të aktivitetit mësimor e të veprimtarive kërkimore-shkencore të Universitetit të Tiranës në ambientet e Kopshtit Botanik.

3. Bashkisë Tiranë i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pasurive të përcaktuara në shtojcën nr. 1, të këtij vendimi, apo t'i tjetërsojë ato.

4. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr. 430, datë 2.7.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Universitetit të Tiranës", të ndryshuar, hiqet prona me numër rendor 14, me emërtimin "Kopshti Botanik".

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Universiteti i Tiranës, Bashkia Tiranë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA NR. 1

1. Pasuria me nr. 353/1, zona kadastrale 3292, e llojit "rezervuar", me sipërfaqe 17 519 m^2, në pronësi shtet.

2. Pasuria me nr. 353/2, zona kadastrale 3292, e llojit "truall", me sipërfaqe 57 437 m^2, në pronësi shtet.

3. Pasuria me nr. 353/4, zona kadastrale 3292, e llojit "arë", me sipërfaqe 21 600 m^2, në pronësi shtet.

4. Pasuria me nr. 353/10, zona kadastrale 3292, e llojit "arë", me sipërfaqe 3 900 m^2, në pronësi shtet.

5. Pasuria me nr. 353/11, zona kadastrale 3292, e llojit "ullishte", me sipërfaqe 8440 m^2, në pronësi shtet.

6. Pasuria me nr. 350, zona kadastrale 3292, e llojit "rrugë", me sipërfaqe 452 m^2, në pronësi shtet.

7. Pasuria me nr. 311, zona kadastrale 3292, e llojit "truall", me sipërfaqe 2456 m^2, në pronësi shtet

.



KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

A - SEKSIONI I IDENTIFIKIMIT TË PASURISË

B - SEKSIONI I PËRSHKRIMIT TË PASURISË

C - SEKSIONI I PRONËSISË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË ZYRA E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME SEKRETARI

D - SEKSIONI I QIRAVE, NE PERDORIM, MARRJE VESHJE E KUTIZUESE, SERVIETAVE DHE INTERESAVE TE TJERA

Nr. Dok.	Data e Regjistrimit	Lloji	Përshkrimi	Data e Lëshimit të Certifikatës	Shënime	Firma

I - SEKSIONI I BIBLIOTEKAVE, VESHJEVE TE GJYKATES, KUTIZIMEVE, etj.

Nr. Dok.	Data e Regjistrimit	Lloji	Përshkrimi	Data e Lëshimit të Certifikatës	Shënime	Firma



KARTELA E PASURISE SE PALUAJTSHME

A - SEKSIONI I IDENTIFIKIMIT TE PASURISE

Zona Kadastrale 3292 NR. I PASURISE 353/4

Adresa e pasurisë - Rruga FSHATI

B - SEKSIONI I PERSHKRIMIT TE PASURISE

Sip. Totale e Pasurisë	Nga Sip. Totale, sa Truall	Nga Sip. Totale e Ndertesave
1. ____ m²	1. ____ m²	1. ____ m²
Ref. ____	Ref. ____	Ref. ____
2. 25342 m²	2. ____ m²	2. ____ m²
Ref. 01.11.1996	Ref. ____	Ref. ____
3. 17519 m²	3. ____ m²	3. ____ m²
Ref. 8105	Ref. ____	Ref. ____
4. ____ m²	4. ____ m²	4. ____ m²
Ref. ____	Ref. ____	Ref. ____

PALAJ

KORIGJUAR SIPERFAQJA PER GJEDHJE TE PAS. NR. 353/12 VOL. 40 FQ. 127, SIPAS VENDIMIT TE KOMISIONIT 111/2007 REF. 8105

C - SEKSIONI I PRONESISE

Nr. Prok.	Data Regjistrimit	Forma, Akesia, Vleresimi	Nr. Pasqyre	I.T.R.	Adresa e Pronarit	Shkaqet e Pageses	Data e Leshimit te Certifikates	Shenime	Leshoi
	2.6.1994	SHITBLERJE			FSHATI				

REPUBLIKA E SHQIPERISE ZYRA E REGJISTRIMIT TE PRONAVE SHKODER

D - SEKSIONI I QIRAVE, NE PERIUDHE, MARREVESHJEVE KUFIZUESE, SERVITUTAVE DHE INTERESAVE TE TJERA

Nr. Dok.	Data e Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lesh. e Certifikatës	Shënime	Firma

E - SEKSIONI I HIPOTEKAVE, VENDIMEVE TE GJYKATES, KUFIZIMEVE etj.

Nr. Dok.	Data e Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lesh. e Certifikatës	Shënime	Firma

KARTELA E PASURISE SE PALUAJTSHME

A - SEKSIONI I IDENTIFIKIMIT TE PASURISE

B - SEKSIONI I PERSHKRIMIT TE PASURISE

C - SEKSIONI I PRONESISE

D - SEKSIONI I QIRAVE, NË PERIORIN E MARRËVESHJEVE TË KUFIZIMIT, SËRVITUTEVE APO INTERESAVE TË TJERA

Nr. Rreg.	Data e Regjistrimit	Faqe	Përshkrimi	Data e Lëshimit të Certifikatës	Shënime	Firma

E - SEKSIONI I HIPOTEKAVE, VENDIMEVE TË GJYKATËS, KUFIZIMEVE, etj.

Nr. Rend.	Data e Regjistrimit	Faqe	Përshkrimi	Data e Lëshimit të Certifikatës	Shënime	Firma



KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

A - SEKSIONI I IDENTIFIKIMIT TË PASURISË

B - SEKSIONI I PËRSHKRIMIT TË PASURISË

C - SEKSIONI I PRONËSISË

II - SEKSIONI I QIRAVE, NE PERDORIM, MARRJA ESHTJE KUFIZUESE, SERVITUTAVE DHE INTERESAVE TE TJERA

Nr. Dok.	Data e Regjistrimit	Lloji	Përshkrimi	Data e Lësh. të Certifikatës	Shënime	Faqja

F - SEKSIONI I HIPOTEKAVE, VENDIMEVE TE GJYKATES, KUFIZIMEVE, etj.

Nr. Dok.	Data e Regjistrimit	Lloji	Përshkrimi	Data e Lësh. të Certifikatës	Shënime	Faqja



KARTELA E PASURISE SE PALUAJTSHME

A - SEKSIONI I PERSHKRIMIT TE PASURISE

B - SEKSIONI I PERSHKRIMIT TE PASURISE

C - SEKSIONI I PRONESISE

REPUBLIKA E SHQIPERISE ZYRA KADASTRALE TIRANE

D - SEKSIONI I QIRAVE, NË PËRDORIM, MARRËVESHJEVE KUFIZUESE, SERVITUTAVE DHE INTERESAVE TË TJERA

Nr. Dok.	Data e Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lëshimit të Certifikatës	Shënime	Faqe

E - SEKSIONI I HIPOTEKAVE, SHITJEVE, TË GJYKATËS, KUFIZIMEVE, etj.

Nr. Dok.	Data e Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lëshimit të Certifikatës	Shënime	Faqe



KARTELA E PASURISE SE PALUAJTSHME

Vol. 3 Fq. 149

SESIONI I IDENTIFIKIMIT TE PASURISE

Zona Kadastrale: NR. i PASURISE: 353/11

Vijon nga: Vol. Fq.

Vijon te: Vol. Fq. dert të: Vol. Fq.

Indeksi i Hartës:

PERFUNDIMTARE (data):

Adresa e pasurisë: Rrethi Q/P

Rr/L. P/G Sh. K. Ap.

Përshkrimi i Veçantë

SESIONI I PERSHKRIMIT TE PASURISE

Lloji i Pasurisë: Brenda V.K.N.: Jo ---> Po. Ref.:

Sip. Totale e Pasurisë	Nga Sip. Totale: sa Truall	Nga Sip. Totale: sa Ndërtesë
1. m²	1. m²	1. m²
Ref.	Ref.	Ref.
2. m²	2. m²	2. m²
Ref.	Ref.	Ref.
3. m²	3. m²	3. m²
Ref.	Ref.	Ref.
4. m²	4. m²	4. m²
Ref.	Ref.	Ref.

Per pjesën e përbashkët:

PALLAT

Kuota e Pjesëmarrjes:

%

Nr. i Pasurisë (Pallati):

Vol. Fq.

SESIONI I PRONESISE

Nr Dok	Data Regjistrim	Emri Atësia Mbiemri	Nr. Pasap	I/E/D	Adresa e Pronarit	Shuma e Paguar	Data e Lesh. Çertifikatës	Shënime	Firma

REPUBLIKA E SHQIPËRISË ZYRA E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME

D - SEKSIONI I QIRAVE, NE PERDORIM, MARREVESHJEVE KUFIZUESE, SERVITUTAVE DHE INTERESAVE TE TJERA

Nr. Dok	Data e Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lësh. të Certifikatës	Shenime	Firma

E - SEKSIONI I HIPOTEKAVE, VENDIMEVE TE GJYKATES, KUFIZIMEVE, etj.

Nr. Dok	Data e Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lësh. të Certifikatës	Shenime	Firma



KARTELA E PASURISE SE PALUAJTSHME

Vol. 8 Fq. 75

--> Vijon nga: Vol. _____ Fq. _____

Vijon në: Vol _____ Fq. _____ dera në: Vol. _____ Fq. _____ -->

PERFUNDIMTARE (data) 16/01/1996

Përshkrim i Veçantë

Nr. Kadastrale 3292 NR. I PASURISE: 311

Bl.: Hartës. 6-34 (00-(1-1-1)

Adresa e pasurisë : Rrethi _____ Bashkia _____

Rr/L _____ P/G _____ Sh ____ K ____ Ap ____

SHENIME I PERSHKRIMIT TE PASURISE

Ndërtesë : _____ Brenda V.K.N. : Po ---> Po. Ref : _____

Sipërfaqe e Pasurisë	Nga Sip. Totale sa Truall	Nga Sip. Totale sa Ndërtesë
_____ m²	1. _____ m²	1. _____ m²
_____	Ref _____	Ref _____
2656 m²	2. 2656 m²	2. _____ m²
_____	Ref _____	Ref _____
_____ m²	3. _____ m²	3. _____ m²
_____	Ref _____	Ref _____
_____ m²	4. _____ m²	4. _____ m²
_____	Ref _____	Ref _____

Per pjesën e pabashkët:

PALLAT

Kuota e Pjesëmarrjes

_____ %

Nr. i Pasurisë (Palla):

Vol. _____ Fq. _____

SHENIME I PRAPESISE

Nr.	Data Regjistrim	Emri Atësia Mbiemri	Nr Pasap	D/Vl/D	Adresa e Plotsuari	Shuma e Paguar	Data e Lësh. Certifikatës	Shënime	Firma
	26.1.97	[illegible]			[illegible]				

Kodet: K/F/B (regjistër) - nr. dok. id., pasaportë, fletë-njoftim, etj. - përkatësia e familjes: B - bashkëpronar (%)

D - SEKSIONI I QIRAVE, NE PERDORIM, MARREVESHJEVE KUFIZUESE, SERVITUTAVE DHE INTERESAVE TE TJERA

Nr. Dok	Data e Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lësh. të Certifikatës	Shënime

E - SEKSIONI I HIPOTEKAVE, VENDIMEVE TE GJYKATES, KUFIZIMEVE, etj.

Nr. Dok	Data e Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lësh. të Certifikatës	Shënime

VENDIM
Nr. 511, datë 17.7.2019

PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUSIT, NGA KATEGORIA E RESURSIT "TOKË BUJQËSORE" NË "TOKË URBANE", TRUALL, TË PASURISË ME NUMËR 78/39, ZONA KADASTRALE 3184, BASHKIA DURRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të statusit, nga kategoria e resursit "tokë bujqësore" në "tokë urbane", truall, të pasurisë me numër 78/39, zona kadastrale 3184, fshati "Rinia", njësia administrative "Katund i Ri", Bashkia Durrës, sipas certifikatës së pasurisë dhe hartës treguese, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës, qarku Durrës, të pasqyrojë në dokumentacionin kadastral (LN) ndryshimin e statusit të resursit, nga "tokë bujqësore" në "tokë urbane", truall, të pasurisë me numër 78/39, zona kadastrale 3184, fshati "Rinia", njësia administrative "Katund i Ri", Bashkia Durrës.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Qarkut Durrës, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës në qarkun Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

ÇERTIFIKATË 1165424

PËR VËRTETIM PRONËSIE

Zyra e Regjistrimit DURRËS Zona Kadastrale Nr. 3184

Numri i Pasurisë 78/39 Volumi 11 Faqe 122

Adresa e Pasurisë RINIA

Lloji i Pasurisë ARË

Sipërfaqja Totale 15876 m²

Nga kjo : Sa Truall — Nga kjo : Sa Ndërtesa —

Nga pallat : Kuota e pjesëmarrjes — %

KJO ÇËRTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti (Zotërinjtë)

Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa	Adresa
BUJAR		DOMI	B	RINIA - DURRËS
IRENA		DOMI	B	RINIA - DURRËS

- është pronar i
- janë bashkëpronarë ejpsa pjeseve më lart 78/39
- është përfaqësuesi i familjes e cila ka në pronësi
- kufizimet e pasurisë janë : V 78/26 L 78/8 J P

Kjo certifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Kjo certifikatë lëshohet etpas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë 10-11-2015 Nr. 25521

Data e lëshimit të certifikatës

11. 11. 2015

Lëshuesi i certifikatës

REGJISTRUESI

DURRËS

HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT
TE PASURIVE TE PALUAJTSHME

DURRES

REGJISTRUESI I RRETHIT
JURGIS ÇYRBA

A. IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE 3184 NR.PASURISE 78/39 Vol. II FQ 122

INDEKSI I HARTES K-34-87-(123-c) SHKALLA 1:2500 SIP = 15876m²

ADRESA E PASURISE : Rrethi Durres Q/F Rivia

Rr/L – P/G – Sh – K – Ap –

B. KUFIZIME

V. PASURIA Nr 78/26

L. PASURIA Nr 78/8

J. PASURIA Nr –

P. PASURIA Nr 81

C. PRONARI

Bujar Domi dh

D. Data 11 / 11 / 2015 Ora 11°°



09/06/2017

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRES

LEJE ZHVILLIMI
Nr. 321, datë 09.06.2017

Mbështetur ne nenet 7/2 dhe 44, shkronja "a" të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 " Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore ", i ndryshuar, nenet 37 dhe 38 të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 " Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit ", i ndryshuar, nenet 9, 10, 10/1 dhe 45 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 " Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit ", i ndryshuar, dhe bazuar në Vendimin nr. 1, datë 30.07.2015 të Këshillit Komëtar të Territorit, i ndryshuar, pas shqyrtimit të kërkesës nr. Prot. 4170 , datë 15.05.2017, për leje zhvillimi për në pasurinë me nr. pasurie 78/39, ZK 3184, në pronësi të Bujar dhe Irena DOMI me kufij (V/J L/P), sipërfaqe 15876 m2 dhe adresë Ishati Rinia , dhe dokumentacionit shoqërues të kërkesës si vijon:

- Prokure per autorizimin e aplikuesit
- Kopje e dokumentit te pronesise
- Projekt-ideja paraprake
- Formati i aplikimit, i nënshkruar elektronikisht
- Prokure per autorizimin e aplikuesit
- Formati i aplikimit, i nënshkruar elektronikisht

VENDOSA:

1. LËSHIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR ne pasurinë me nr. pasurie 78/39, ZK 3184 në pronësi të Bujar dhe Irena DOMI, me kufij (V/J L/P), sipërfaqe 15876 m2 dhe adresë Rinia, sipas paraqitjes grafike në shkallë të fragmentit të hartës në gjendjen ekzistuese që është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Distancat (nga kufiri i pronës, nga objekti fqinjë, nga trupi i rrugës etj.) dhe Sipas VKM 408 e ndryshuar

2. VËRTETIMËRIA E LEJES

Kjo leje është e vlefshme deri në hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të kësaj bashkie me vendim të autoritetit përgjegjës dhe, në çdo rast, deri në ndryshimin e statusit apo kufijve të pronës. Në këto raste, zhvilluesi duhet të aplikojë për leje të re zhvillimi që të mund të pajtohet me leje ndërtimi për zhvillimin e pronës.

Dr. D.P.K.Zh.T.
Adhurim Qehajaj ark.
Adhurim Qehajaj
Digitally signed by Adhurim Qehajaj
Date: 2017.06.09 14:38:30 +01'00'

KRYETARI I BASHKISË
Z. VANGJUSH DAKO
Vangjush Dako
Digitally signed by Vangjush Dako
Date: 2017.06.09 14:39:02 +01'00'

Tiranë, më datë 24 Tetor 2017

MARRËVESHJE PARAPRAKE BASHKËPUNIMI

E lidhur ndermjet palëve :

i. Federata Shqiptare e Futbollit, me seli ne Tiranë, Rruga "Kavajës" Nr.", perfaqësuar nga Sekretari I Përgjithshëm z.Ilir Shulku, këtu e më vijon "FSHF"

dhe

ii. Kompleksit "Olympic Park Durrës" me përfaqësues ligjor z.Bujar Domi, i ne cilësinë administrator) regjistruar pranë QKB me (NUIS)I414175010, me adresë, Durrës KATUNDI RI, Sektor Pinia.

Të cilat ranë dakort per sa vijon :

Neni 1
BAZA LIGJORE

Kjo marrëveshje hartohet në bazë dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë. Pregullimi dhe interpretimi i saje, do të bëhet në përputhje me këtë kod dhe me legjislacionin shqiptar të aplikueshem.

Neni 2
OBJEKTI

Objekt I kësaj marrëveshje është realizimi I aktiv teteve të ndryshme sportive (ndeshje dhe stërvitje te Ekipeve Kombëtare te Futbollit) sipas nevojave që FSHF do të kërkë pasi Kompleksi "Olympic Park Durrës" të përfundojë dhe të plotesojë të gjitha kriteret dhe standartet e kërkuara nga FIFA dhe UEFA, të cilat janë parashtruar në një projekt pranë FSHF. *(bashkangjitur kësaj marrëveshje projekti)*

Neni 3
KOHËZGJATJA E MARRËVESHJES DHE HYRJA NË FUQI

Kjo marrëveshje paraprake hyn në fuqi sot më dt. 24.10.2017 dhe do të pasoi et me nje kontratë bashkëpunimi ku do të percaktohen edhe kushtet financiare për mirëmbajtjen e aktiviteteve të FSHF-së pranë kompleksit "Olympic Park Durrës" pasi ky I fundit përfundon dhe marr miratimin nga Komisioni I Licencimit te Klubeve, pas raportit te paraqitur nga Monaxheri I Licencimit pas inspektimit te kryer në kompleks.

Neni 4
HARTIMI DHE NENSHKRIMI I MARRËVESHJES

Kjo marrëveshje u hartua në dy kopje autentike, nga një për secilën palë.
Palët pasi e lexuan, kuptuan permbajtjen dhe e pranuan, me vullnet të lirë e mënsh rua, ne ate.

Nënshkruar në Tiranë, më datë 24 Tetor 2017.

"Federata Shqiptare e Futbollit"
Sekretar I Përgjithshëm
z.Ilir Shulku

Kompleksi "Olympic Park Durrës"
Administratori
z. Bujar Domi

VENDIM
Nr. 512, datë 17.7.2019

PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT TË Z. VLADIMIR GROSHA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 99/2018, "Për buxhetin e vitit 2019", dhe të vendimit nr. 46, datë 30.1.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2019", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Vladimir Grosha, në masën 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë.
2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.
3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave përkatëse të institucionit të kurimit.
4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

URDHËR I PËRBASHKËT
Nr. 292, datë 28.5.2019

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ZBATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT NDËRMJET TRI MINISTRIVE "PËR IDENTIFIKIMIN DHE REGJISTRIMIN NË SHKOLLË TË TË GJITHË FËMIJËVE TË MOSHËS SË DETYRIMIT SHKOLLOR"

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të shkronjës "c" të nenit 25 të ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar, të ligjit nr. 18/2017, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës" dhe të udhëzimit nr. 12, datë 27.4.2015, i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, "Për mbledhjen, përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale të punonjësve arsimore të institucioneve arsimore parauniversitare dhe të nxënësve, si dhe për përmbajtjen e dosjeve të tyre personale", i ndryshuar

URDHËROJMË:

1. Miratimin e Rregullores për zbatimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet tri ministrive, protokolluar në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) me nr. 7522 prot., datë 12.7.2018, në Ministrinë e Brendshme (MB) me nr. 8649 prot., datë 22.10.2018 dhe në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MShMS) me nr. 6084 prot., datë 23.10.2018, "Për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor".
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij Urdhri të përbashkët Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të gjitha institucionet dhe strukturat në varësi të këtyre ministrive, të përcaktuara në Marrëveshje dhe në Rregullore.

Ky urdhër i përbashkët hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Besa Shahini

MINISTËR I BRENDSHËM
Sandër Lleshaj

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

RREGULLORE
PËR IDENTIFIKIMIN DHE REGJISTRIMIN NË SHKOLLË TË TË GJITHË FËMIJËVE TË MOSHËS SË DETYRIMIT SHKOLLOR

Neni 1
Objekti i Rregullores

Objekti i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i procedurave, detyrave dhe përgjegjësive të institucioneve shtetërore për zbatimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet tri ministrive, protokolluar në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) me nr. 7522 prot., datë 12.7.2018, në Ministrinë e Brendshme (MB) me nr. 8649 prot., datë 22.10.2018 dhe në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MShMS) me nr. 6084 prot., datë 23.10.2018, "Për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor".

Neni 2
Përbërësit e listës së fëmijëve

Lista e fëmijëve, që duhet të ndjekin klasën e parë, përmban këta përbërës:

Emri, mbiemri, emri i babait, emri i nënës, numri personal, gjinia, datëlindja, vendlindja dhe vendbanimi.

Neni 3
Data e fillimit të vitit shkollor

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, mbështetur në Urdhrin e Përbashkët për miratimin e strukturës së vitit shkollor në sistemin arsimor parauniversitar, brenda datës 1 mars të çdo viti, u dërgon në format elektronik, datën e fillimit të vitit të ardhshëm shkollor Ministrisë së Brendshme (MB) dhe institucioneve arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, brenda datës 5 mars të çdo viti, u dërgojnë, me shkresë zyrtare, qendrave shëndetësore përkatëse datën e fillimit të vitit të ardhshëm shkollor.

Neni 4
Lista e fëmijëve nga qendrat shëndetësore

Qendrat shëndetësore, brenda datës 2 prill të çdo viti, i dërgojnë në format elektronik dhe/ose me shkresë zyrtare, listën e fëmijëve që duhet të ndjekin klasën e parë* Drejtorisë Rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor / Njësisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor sipas përbërësve të parashikuar në nenin 2.

(*Fëmijët që kanë detyrimin të regjistrohen në klasën e parë, janë ata që mbushin moshën 6 vjeç deri një ditë para fillimit të vitit shkollor.)

Neni 5
Lista e fëmijëve nga Ministria e Brendshme

Ministria e Brendshme, brenda datës 10 prill të çdo viti, i dërgon MASR-së, në format elektronik, listën e fëmijëve që duhet të fillojnë klasën e parë në vitin e ardhshëm shkollor, sipas përbërësve të parashikuar në nenin 2.

Neni 6
Lista e fëmijëve nga institucionet shëndetësore

Drejtoria Rajonale e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor/Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, brenda datës 10 prill të çdo viti, hartojnë në format elektronik listën përmbledhëse të të dhënave të paraqitura nga qendrat shëndetësore dhe ua dërgojnë atë institucioneve arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Neni 7
Bashkëpunime të institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar

Çdo institucion arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, brenda datës 10 prill të çdo viti, me qëllim evidentimin e fëmijëve që janë në rrezik të mos ndjekin klasën e parë, kryen veprimtaritë si më poshtë:

a) bashkëpunon me Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijëve;

b) bashkëpunon me shkollat në të cilat janë evidentuar probleme në ndjekjen e procesit mësimor nga ana e fëmijëve të klasës së parë.

Neni 8
Lista e fëmijëve nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

MShMS-ja dërgon në MASR, brenda datës 15 prill të çdo viti, në format elektronik, listat e parashikuara në nenin 6.

Neni 9
Lista e fëmijëve për Qendrën e Shërbimeve Arsimore

MASR-ja i dërgon Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QShA), brenda datës 20 prill të çdo viti listat e parashikuara në nenet 5 dhe 8.

Neni 10
Detyra të Qendrës së Shërbimeve Arsimore

Qendra e Shërbimeve Arsimore, brenda datës 10 maj:

a) harton listën e fëmijëve që duhet të ndjekin klasën e parë në vitin e ardhshëm shkollor, bazuar në listat e parashikuara në nenet 5 dhe 8;

b) përpilon listat e fëmijëve që duhet të ndjekin klasën e parë në vitin e ardhshëm shkollor për çdo institucion arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar;

c) i dërgon çdo institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, listën përkatëse me postë elektronike dhe me shkresë zyrtare.

Neni 11
Lista e fëmijëve për çdo shkollë

Institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, brenda datës 25 maj të çdo viti, u dërgon në format elektronik dhe me shkresë zyrtare, të gjitha shkollave publike dhe atyre private në juridiksionin e tij, listën e parashikuar në nenin 10, të plotësuar me të dhënat e parashikuara në nenin 2. Kjo listë u shërben shkollave si bazë referuese për regjistrimin e fëmijëve në klasën e parë në dy javët e fundit të muajit qershor dhe deri një ditë para fillimit të vitit shkollor në shtator.

Neni 12
Lista e fëmijëve të regjistruar në klasën e parë

Drejtorët e shkollave publike dhe private, brenda 3 ditëve pune pas datës së fillimit të çdo viti shkollor, i dërgojnë institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, në format elektronik dhe me shkresë zyrtare, listën emërore të fëmijëve që janë të regjistruar në klasën e parë, duke pasur parasysh përbërësit e parashikuar në nenin 2.

Neni 13
Detyra të institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar

Çdo institucion arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, bazuar në raportimet sipas nenit 12, brenda 5 ditëve pune nga njoftimet e shkollave, harton në format elektronik këto dokumente:

a) Listën e fëmijëve të paregjistruar në klasën e parë, sipas zonës që i takon çdo shkolle publike të arsimit bazë në juridiksion.

b) Listën e fëmijëve të paregjistruar në klasën e parë, sipas zonave që mbulojnë njësitë administrative përkatëse, sipas modelit të paraqitur te shtojca.

c) Listën e fëmijëve të paregjistruar në klasën e parë, sipas zonave që mbulojnë komisariatet e policisë, sipas modelit të paraqitur te shtojca.

Neni 14
Bashkëpunimi i institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, me kryetarin e bashkisë, shefin e komisariatit të policisë dhe prefektin

Çdo institucion arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, i dërgon menjëherë, në format elektronik dhe me shkresë zyrtare, kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore (Bashkisë/ ndërlidhësit komunitar/kryetarit të fshatit) dhe shefit të Komisariatit të Policisë dhe, për dijeni, Prefektit, listën e fëmijëve që ende nuk janë regjistruar në klasën e parë, të parashikuar në shkronjat "b" dhe "c" të nenit 13 dhe në shtojcën me të dhënat për çdo fëmijë.

Neni 15
Detyra të kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore

Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore, brenda 4 ditëve pune nga marrja në dijeni e shkresës zyrtare të dërguar nga institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, të parashikuar në shkronjën "b" të nenit 13, duke pasur parasysh adresat e fëmijëve, përcjell për plotësim shtojcën te personi përgjegjës i njësisë administrative.

Neni 16
Detyra të shefit të Komisariatit të Policisë

Shefi i Komisariatit të Policisë, brenda 4 ditëve pune nga marrja në dijeni e shkresës zyrtare të dërguar nga institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, të parashikuar në shkronjën "c", të nenit 13, duke pasur parasysh adresat e fëmijëve, përcjell për plotësim shtojcën te punonjësi i policisë së zonës.

Neni 17
Detyra të njësisë administrative dhe njësisë së vetëqeverisjes vendore

1. Personi përgjegjës i njësisë administrative, brenda 6 ditëve pune nga marrja në dijeni e kërkesës nga kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore, kryen verifikimet në terren, plotëson shtojcën për çdo fëmijë dhe ia dërgon atë kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

2. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore, shtojcën e plotësuar ia përcjell, një ditë pas marrjes nga personi përgjegjës i njësisë administrative, institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, nga i cili ka ardhur kërkesa, si dhe informon Prefektin me shkresë zyrtare për ecurinë e procesit.

Neni 18
Detyra të Komisariatit të Policisë

1. Punonjësi i policisë së zonës, brenda 6 ditëve pune nga marrja në dijeni e kërkesës nga shefi i Komisariatit të Policisë, kryen verifikimet në terren, plotëson shtojcën për çdo fëmijë dhe ia dërgon atë shefit të Komisariatit të Policisë.

2. Shefi i Komisariatit të Policisë, shtojcën e plotësuar ia përcjell, një ditë pas marrjes nga punonjësi i policisë së zonës, institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, nga i cili ka ardhur kërkesa, si dhe informon Prefektin me shkresë zyrtare për ecurinë e procesit.

Neni 19
Lista e fëmijëve të paregjistruar

Çdo institucion arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, brenda datës 15 tetor të çdo viti, u dërgon, në format elektronik ose/dhe me shkresë zyrtare, shkollave publike, që kanë raportuar fëmijë të paregjistruar, listën e fëmijëve me të dhënat e plotësuara nga përgjegjësi i njësisë administrative dhe punonjësi i policisë së zonës dhe që i takojnë shkollës.

Neni 20
Bashkëpunime për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të fëmijëve të moshës e detyrimit shkollor

Shkollat bashkëpunojnë me Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve (NjMF) dhe punonjësin e mbrojtjes së fëmijëve (PMF) për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë, brenda datës 31 tetor të çdo viti, të fëmijëve që kanë mbushur moshën e detyrimit shkollor, por që nuk ndjekin shkollën ose janë të shfrytëzuar ekonomikisht, përfshirë fëmijët në situatë rruge, si dhe të fëmijëve që i përkasin zonës së tyre, bazuar në shkresën zyrtare të parashikuar në nenin 19.

Neni 21
Lista e fëmijëve të paidentifikuar

1. Çdo institucion arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, brenda datës 20 tetor të çdo viti, harton listën e fëmijëve që nuk janë identifikuar nga përgjegjësit e njësive administrative ose punonjësit e policisë së zonave, ose që rezultojnë të transferuar, dhe e dërgon në QShA.

2. QShA-ja, brenda muajit tetor të çdo viti, përmbledh listat e parashikuara në pikën 1 të këtij neni dhe ua dërgon institucioneve arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, të dhënat për fëmijët ende të paidentifikuar si dhe për fëmijët e transferuar.

3. Çdo institucion arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, njofton menjëherë shkollat publike përkatëse bazuar në listën e parashikuar në pikën 2 të këtij neni.

4. Mësuesit e shkollave publike përkatëse merren me regjistrimin e fëmijëve të parashikuar në listën e ardhur në shkollë sipas pikës 3 të këtij neni.

Neni 22

Regjistrimi i fëmijëve të paidentifikuar dhe i fëmijëve të transferuar

Drejtori i shkollës publike njofton institucionin arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, për efektivitetin e përpjekjeve për regjistrimin e fëmijëve të parashikuar në pikën 4 të nenit 21.

Neni 23

Monitorimi i procesit nga prefekti

1. Për çdo mosrespektim afati, organi pritës njofton menjëherë me shkresë zyrtare organin dërgues dhe Prefektin.

2. Prefekti organizon monitorimin e procesit dhe, për rastet e mosplotësimit të detyrave, merr masat e nevojshme për zbatimin e kësaj Rregulloreje nga institucionet përgjegjëse.

Neni 24

Shkëmbimi i informacioneve ndërmjet tri ministrive

Ministritë e përfshira në këtë Rregullore, krahas informacioneve të tjera të nevojshme, shkëmbejnë edhe informacione në format shkresor ose elektronik mbi problematikat që mund të lindin gjatë zbatimit të Rregullores.

Neni 25

Komisioni Ndërministror i Ndjekjes së Arsimit nga Nxënësit

Zëvendësministri i MASR-së drejton Komisionin Ndërministror të Ndjekjes së Arsimit nga Nxënësit, që përbëhet prej tij dhe zëvendësministrave të MShMS-së dhe MB-së të ngarkuar për zbatimin e Marrëveshjes dhe të Rregullores.

(Shënim. Kjo Rregullore shoqërohet me një shtojcë prej dy faqesh).

SHTOJCË

Udhëzime për plotësimin e tabelës A:

- Te tabela A më poshtë vendosni shenjën "V" aty ku duhet.
  P.sh., kur familja e fëmijës nuk është më banore e zonës, vendosni shenjën "V" te kolona 1.
- Vendosni shenjën "V" te kolona 3 kur, nga kërkimi juaj, del se familja është transferuar, por nuk dihet se ku.
- Kur informoheni se familja e fëmijës është jashtë shtetit, shënoni "V" te kolona 4 dhe, po të gjeni edhe shtetin, shkruani edhe emrin e shtetit.
- Kur informoheni se ku është transferuar familja e fëmijës, vendosni te kutiza përkatëse të dhënat për vendin ku është transferuar.
- Te kolona 2, shkruani ku është transferuar familja e fëmijës. Lini bosh, kur nuk gjeni dot një të dhënë, p.sh.: adresën e familjes.
- Te kolona 5, "Të tjera" shkruani çdo rast tjetër që nuk është parashikuar te kjo tabelë, p.sh.: "Fëmija nuk është në gjendje të lëvizë".
- Te kolona "Burimi", shënoni se nga e morët informacionin për familjen e fëmijës ose për vetë fëmijën, p.sh.: "Nga fqinji", "Nga vëllai i fëmijës" etj.

Në çdo rast, shkruani emrin e burimit.
Për çdo fëmijë, do të plotësoni një tabelë.

TABELA A

Të dhënat e fëmijës		1 Familja nuk është më banore e zonës	2 Familja është transferuar në:	3 Familja është transferuar, brenda vendit, por nuk dihet se ku	4 Familja është jashtë shtetit, shëno shtetin	5 Të tjera informacione	6 Burimi
Emri			Qarku _____				
Mbiemri							
Emri i babait			Bashkia _____				
Emri i nënës							
Numri personal			Njësia Administrative _____				
Gjinia							
Datëlindja			Adresa _____ _____				
Vendlindja							
Njësia administrative							

Hartuar nga _____ Data _____ Firma _____

FËMIJË QË DUHET TË NDJEKIN KLASËN E PARË DHE QË NUK NDODHEN NË LISTËN E DËRGUAR

Udhëzime për plotësimin e tabelës B:

Përveç fëmijëve për të cilët ju plotësoni tabelën A, d.m.th. i dini emrin, emrin e babait etj., gjatë kërkimeve tuaja mund të zbuloni fëmijë të tjerë të cilët nuk janë regjistruar në klasën e parë. Ky do të jetë një kontribut tjetër i juaji për të ndihmuar që çdo fëmijë të nisë shkollën.

Do të duhet të pyesni sa më shumë banorë të zonës për të gjetur këta fëmijë.

- Te tabela më poshtë B, te kolona "Të dhënat e fëmijës" shkruani sa më shumë të dhëna që gjeni për fëmijën.
- Te kolona "Të tjerat" shkruani çdo informacion tjetër të vlefshëm për regjistrimin e fëmijës, p.sh.: "Është në moshën 7 vjeç (ose 8 vjeç"), "Ka qenë në klasën e parë, por e ka braktisur" etj.
- Te kolona "Burimi" shënoni se nga e morët informacionin për fëmijën, p.sh.: "Nga fqinji", "Nga vëllai" etj.

Plotësoni aq tabela të mëposhtme sa fëmijë gjeni.

TABELA B

Të dhënat e fëmijës		**Të tjera**	**Burimi**
Emri			
Mbiemri			
Emri i babait			
Emri i nënës			
Numri personal			
Gjinia			
Datëlindja			
Vendlindja			
Njësia administrative			

Hartuar nga_____Data_____Firma_____

NJOFTIM
Nr. 10267, datë 15.7.2019

MBI HYRJEN NË FUQI TË NJË MARRËVESHJEJE

Marrëveshja për Mbrojtjen dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm të Zonës së Parkut të Prespës, nënshkruar më 2 shkurt 2010, ka hyrë në fuqi më datë 29 maj 2019.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I
MINISTRISË PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Gazmend Barbullushi

NJOFTIM
Nr. 10269, datë 15.7.2019

MBI HYRJEN NË FUQI TË NJË MARRËVESHJEJE SHUMËPALËSHE

Marrëveshja ndërmjet palëve të Konventës së bashkëpunimit policor për Evropën Juglindore për shkëmbimin e automatizuar të të dhënave të ADN-së, daktiloskopike dhe të të dhënave të regjistrimit të automjeteve dhe marrëveshjes së saj zbatuese, nënshkruar më datë 13 shtator 2018, do të hyjë në fuqi më 11 gusht 2019.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I
MINISTRISË PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Gazmend Barbullushi

VENDIM
Nr. 26, datë 31.5.2019

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS PEQIN SHA

Në mbështetje të nenit 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë" (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar (rregullore e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 31.5.2019, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Mbi miratimin e projektvendimit: 'Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës Peqin sh.a.'",

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjellës Peqin (U. Peqin) me shkresën nr. 1 prot., datë 15.1.2019 dhe shkresës nr. 31 prot., datë 5.4.2019, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për licencim për shkak të mbarimit të afatit dhe shtimit të kategorisë së shërbimit të largimit të ujërave të ndotura.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit dhe shtimin e kategorisë së largimit të ujërave të ndotura të U. Peqin në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe rregulloren e licencimit.

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) Shoqëria U. Peqin ofron shërbimin e furnizimit me ujë për 19 150 banorë dhe largimin e ujërave të ndotura për 7 600 banorë në Bashkinë Peqin si më poshtë:

- Zona e shërbimit me furnizim me ujë nga shoqëria U. Peqin:

Nr.	Njësitë administrative të Bashkisë Peqin	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të njësive administrative	Popullsia e shërbyer
1	Peqin	Qyteti i Peqinit	7600
2	Karinë	Karine	1035
3	Pajovë	Pajove	935
		Lazarej	595
		Bishqem	620
		Garunje	120
		Paulesh	600
		Grykesh	610
		Cacabeze	195
4	Gjocaj	Rrumbullake	460
		Vashaj	1235
		Bardhas	425
5	Përparim	Perparim	345
		Fatishe	495
		Lolaj	285
		Urucaj+Copanaj	185
		Kodras	295
		Caushaj	135
6	Shezë	Sheze	360
		Pekisht	1110
		Trash	835
		Karthneke	360
		Algjinaj	315
TOTALI			**19 150 banorë**

Shënim: U. Peqin popullsinë e shërbyer për çdo fshat e ka llogaritur në bazë të kontratave * 5 banorë pasi nuk disponon të dhëna të detajuara për popullsinë në çdo fshat. Në 25 fshatra të Bashkisë Peqin, sh.a. U. Peqin nuk e ofron shërbimin e furnizimit me ujë.

- Zona e shërbimit me kanalizime nga shoqëria U. Peqin:

Nr.	Njësitë administrative të Bashkisë Peqin	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të njësive administrative	Popullsia e shërbyer
1	Peqin	Qyteti i Peqinit	7600
TOTALI			**7600 banorë**

Shënim: Me rrjet të kanalizimeve të ujërave të ndotura mbulohet vetëm pjesa e qytetit, pasi në fshatra nuk ka rrjet të kanalizimeve dhe operojnë me gropa septike.

b) Drejtuesi teknik i shoqërisë z. Amarildo Xhyra mban titullin: "Master Shkencor në Inxhinieri Hidroteknike" marrë në tetor 2017, pranë Universitetit Politeknik Tiranë.

4. ERRU në vlerësimin e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit dhe shtimit të kategorisë së shërbimit të largimit të ujërave të ndotura ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e U. Peqin, të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar, (ligji nr. 9121) për mos lejimin e abuzimit me

pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve;

c) kërkesave të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, "Për mbrojtjen e konsumatorëve", të ndryshuar (ligji nr. 9902);

5. ERRU, në bazë të vlerësimit dhe verifikimeve të kërkesës së shoqërisë U. Peqin, rekomandon:

- Shoqëria U. Peqin duhet të aplikojë pranë ERRU-së për rishikimin e nivelit tarifor pas riorganizimit të shoqërisë sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 63;

- Shoqëria U. Peqin duhet të aplikojë pranë ERRU-së për miratimin e tarifës volumetrike për kanalizimin e ujërave të ndotura, i cili është shërbim i ri për këtë shoqëri.

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e U. Peqin është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjellës Peqin sh.a. me NUIS: K78723108J në kategoritë:

a) Kategoria A - Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

b) Kategoria C - Për largimin e ujërave të ndotura.

2. Shoqëria Ujësjellës Peqin sh.a., autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:

a) Drejtues ligjor: Nazmi Toli;

b) Drejtues teknik: Amarildo Xhyra.

3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjellës Peqin sh.a. është Bashkia Peqin me njësitë administrative si më poshtë:

I. Për kategorinë A - Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik:

a) Peqin;

b) Karinë (pjes.);

c) Pajovë (pjes.);

d) Gjocaj (pjes.);

e) Përparim (pjes.);

f) Shezë (pjes.).

II. Për kategorinë C - Për largimin e ujërave të ndotura:

a) Peqin.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjellës Peqin sh.a. detyrohet të nënshkruajë kushtet e licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjellës Peqin sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

VENDIM
Nr. 28, datë 20.6.2019

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME FUSHË-ARRËZ SHA

Në mbështetje të nenit 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë" (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar (rregullore e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 20.6.2019, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Mbi miratimin e projektvendimit: 'Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Fushë-Arrëz sh.a.'",

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Fushë-Arrëz (UK Fushë-Arrëz), me shkresën nr. 56 prot., datë 9.5.2019 ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU),

kërkesën për licencim për shkak të mbarimit të afatit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit të UK Fushë-Arrëz në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-së nr. 958 dhe rregulloren e licencimit.

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) Shoqëria UK Fushë-Arrëz ofron shërbimin e furnizimit me ujë për 4349 banorë dhe shërbimin e largimit e ujërave të ndotura për 1320 banorë, në Bashkinë Fushë-Arrëz si më poshtë:

- Zona e shërbimit me furnizim me ujë nga shoqëria UK Fushë-Arrëz:

Nr.	Njësitë administrative të Bashkisë Fushë-Arrëz	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të njësive administrative	Popullsia e shërbyer
1	Fushë-Arrëz	Qyteti Fushë-Arrëz	3821
		Fshati Fushë-Arrëz	528
TOTALI			**4349 banorë**

Shënim: Pjesa tjetër e njësive administrative nuk mbulohen me shërbimin e furnizimit me ujë nga UK Fushë-Arrëz.

- Zona e shërbimit me kanalizime nga shoqëria UK Fushë-Arrëz:

Nr.	Njësitë administrative të Bashkisë Fushë-Arrëz	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të njësive administrative	Popullsia e shërbyer
1	Fushë-Arrëz	Qyteti Fushë-Arrëz	1103
		Fshati Fushë-Arrëz	220
TOTALI			**1320 banorë**

Shënim: Pjesa tjetër e njësive administrative nuk mbulohen me shërbimin e kanalizimeve nga UK Fushë-Arrëz.

b) Drejtuesi teknik i shoqërisë z. Anduel Gjinaj, mban titullin: "Master Shkencor në Inxhinieri Gjeomjedisi" marrë në maj 2017.

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Fushë-Arrëz, të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102 si dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar (ligji nr. 9121) për mos lejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve;

5. ERRU-ja, në bazë të vlerësimit dhe verifikimeve të kërkesës së shoqërisë UK Fushë-Arrëz, rekomandon:

- Shoqëria UK Fushë-Arrëz, duhet të aplikojë pranë ERRU-së, për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura;

- Shoqëria UK Fushë-Arrëz, duhet të punojë në drejtim të zgjerimit të zonës së shërbimit, në mënyrë që të gjithë banorët e Bashkisë Fushë-Arrëz të marrin shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura nga kjo shoqëri me cilësi dhe brenda standardeve.

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Fushë-Arrëz është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Fushë-Arrëz sh.a. me NUIS: K19629304M në kategoritë:

a) Kategoria A - Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

b) Kategoria C - Për largimin e ujërave të ndotura.

2. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Fushë-Arrëz sh.a., autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:

a) Drejtues ligjor: Xhon Leka;

b) Drejtues teknik: Anduel Gjinaj.

3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Fushë-Arrëz sh.a., është:

Njësia Administrative Fushë-Arrëz:

Qyteti Fushë-Arrëz

Fshati Fushë-Arrëz.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Fushë-Arrëz sh.a. detyrohet të nënshkruajë Kushtet e Licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Fushë-Arrëz sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

VENDIM
Nr. 29, datë 20.6.2019

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIN E UJËRAVE TË NDOTURA PËR SHOQËRINË UJËSJELLËS-KANALIZIME TROPOJË SHA

Në mbështetje të nenit 13, 14, 21 dhe 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (ligji nr. 8102), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 39, datë 9.12.2015 "Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura" (vendimi nr. 39), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 9.12.2015 "Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura" (vendimi nr. 40), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 9.12.2015 "Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura" (vendimi nr. 41), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 9.12.2015 "Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura" (vendimi nr. 42),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 20.6.2019, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike mbi kërkesën e Ujësjellës-Kanalizime Tropojë sh.a. për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime,

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Tropojë (UK Tropojë) me shkresë nr. 119 prot., datë 19.12.2018 "Kërkesë për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizime", ka paraqitur kërkesën pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) për rritjen e tarifave në zonën e shërbimit për të tre kategoritë e konsumatorëve të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 8102 dhe vendimin nr. 40.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) pasi e gjeti paraqitjen e kërkesës për vendosjen e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura dhe tarifë fikse të shoqërisë UK Tropojë në përputhje me përcaktimet dhe procedurën e parashikuar në vendimin nr. 40, me vendimin nr. 6, datë 1.2.2019, vendosi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për propozimin e bërë nga UK Tropojë për nivelin e ri tarifor për shërbimet UK për të gjithë zonën e riorganizuar të shërbimit në zbatim të VKM nr. 63, datë 27.1.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura."

3. Ujësjellës-Kanalizime Tropojë ka paraqitur dokumentacionin e aplikimit për miratimin e tarifave pranë ERRU me shkresë nr. 119 prot., datë 19.12.2018 "Kërkesë për nivel të ri tarife për

shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizime", për të tre kategoritë e konsumatorëve sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela me tarifat aktuale dhe të propozuara nga shoqëria sipas kategorisë së konsumatorëve:

Kategoritë e Konsumatorëve	Tarifat aktuale		Tarifat e propozuara	Diferenca
	Tarifat sipas vendimit të KKRR nr. 29, datë 13.10.2004	Tarifat që ka zbatuar deri tani me miratimin e Këshillit Mbikëqyrës	Për zonën e shërbimit të riorganizuar	Propozimi i shoqërisë: tarifat aktuale sipas Këshillit Mbikëqyrës
A. Tarifë volumetrike për furnizimin me ujë	lekë/m^3	lekë/m^3	lekë/m^3	lekë/m^3
1. Konsumatorë familjarë (zona urbane)	19	29.2	40	+10.8
1/1. Konsumatorë familjarë (zona rurale)	19	15.8	40	+24.2
2. Konsumatorë publik	60	50	90	+40
3. Konsumatorë privat	80	66.7	100	+33.3
B. Tarifë volumetrike për KUN	lekë/m^3	lekë/m^3	lekë/m^3	lekë/m^3
1. Konsumatorë familjarë	-	-	13	
2. Konsumatorë publik	-	-	22	
3. Konsumatorë privat	-	-	22	
C. Tarifë fikse e shërbimit	lekë/muaj/lidhje	lekë/muaj/lidhje	lekë/muaj/lidhje	lekë/muaj/lidhje
1. Konsumatorë familjarë	-	83	100	+17
2. Konsumatorë publik	-	83	200	+117
3. Konsumatorë privat	-	83	200	+117

Ligjërisht, shoqëria duhet të aplikojë tarifat e miratuara nga ERRU-ja sipas vendimit nr. 29, datë 13.10.2004 "Për miratimin e tarifave për konsum publik të sh.a. Ujësjellës Tropojë", por aktualisht referuar vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr. ekstra, datë 29.12.2013[1] "Për kategorinë e konsumatorëve familjarë për zonën urbane (qyteti Bajram Curri) aplikon tarifën volumetrike 29.2 lek/m^3.

Pikërisht, nisur nga kjo shkelje ligjore, Enti Rregullator i Ujit ka inspektuar këtë shoqëri në datë 10.5.2018, bazuar në Rregulloren e Inspektimit. Ndaj shoqërisë u mor masë administrative, gjobë në shumën 100.000 lekë, për moszbatim të vendimeve të Entit Rregullator të Ujit.

4. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton se treguesit e arritur të performancës për vitin 2017 dhe objektivat e propozuar nga shoqëria UK Tropojë për vitin 2019 janë sipas tabelës së mëposhtme:

[1] Sipas këtij vendimi është përcaktuar një tarifë afrofe me TVSH 800 lekë/muaj/klient familjarë. Në atë periudhë të gjithë klientët ishin pa matës dhe kjo situatë ka qenë deri në vitin 2016. Me vendosjen e matësve, nisur nga kjo tarifë afrofe e cila i korrespondonte një familje me 5 persona shoqëria ka llogaritur tarifën volumetrike 29.2 lekë/m^3 të cilën e aplikon për zonën urbane.

Tabela me treguesit kryesorë të performancës për vitet 2017–2018–2019

Treguesit e performancës	Njësia e matjes	Treguesit e performancës		
		Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019
Mbulimi i kostove direkte të O&M	%	83	84	98
Mbulimi i kostove totale	%	63	60	76
Uji pa të ardhura	%	68.8	64.7	64
Mbulimi me ujë	%	43.6	47.1	51.3
Mbulimi me KUN	%	0	0	29.8
Niveli i matjes	%	72	75	80
Norma e arkëtimit korrente	%	58	63	71
Vazhdimësia e furnizimit me ujë (vetëm për njësitë ku shërbehet)	orë/ditë	10	20	22
Eficienca e stafit	staf/1000 lidhje	14.8	16	10.4

Në metodologjinë e vendosjes së tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura, miratuar me vendimin e KKRR-së nr. 42, datë 9.12.2015, në nenin 16 të saj "Vlerësimi i propozimit për ndryshim tarife – periudha tranzitore" citohet: "Për propozimin e parë për ndryshimin e tarifës, brenda periudhës tranzitore, për rastet kur shtohet një zonë e re si pjesë e zonës së shërbimit të operatorit, sipas kësaj metodologjie do të bëhet vetëm analiza e kostos. Më tej, ERRU-ja do të përcaktojë një grup treguesish bazë performance për çdo operator, të cilët do të shërbejnë si referencë dhe do vlerësohen gjatë ndryshimeve të tarifave për periudhat në vazhdim".

Nisur nga sa më sipër, UK Tropojë është një shoqëri e re e riorganizuar, që aplikon për herë të parë sipas kësaj metodologjie. Shoqëria UK Tropojë bën pjesë në grupin e shoqërive që nuk arrijnë të mbulojnë kostot e operimit dhe mirëmbajtjes, prandaj përmirësimi i këtij treguesi është objektivi kryesor i shoqërisë për vitin 2019.

Nevoja e ndryshimit të tarifave nga ana e UK Tropojë me qëllim gjenerimin e të ardhurave shtesë argumentohet si më poshtë, të cilat vlerësohen nga ERRU-ja:

a) Pas zgjerimit të zonës së shërbimit Shoqëria aplikon për herë të parë sipas metodologjisë "Për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura", miratuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator me vendimin nr. 42, datë 9.12.2015, bazuar në analizën e gjendjes teknike dhe ekonomike të saj, konkretisht analizën e kostove dhe të ardhurave për shërbimet e ofruara, analizën dhe përcaktimin e objektivave për treguesit e performancës.

b) Shoqëria aplikon për miratimin e nivelit të ri tarifor pas një periudhe 15-vjeçare (aplikimi i fundit në vitin 2004) duke propozuar unifikim dhe rritje të tarifës volumetrike për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, kanalizime, si dhe të tarifës fikse të shërbimit për të tri kategoritë e konsumatorëve.

c) Përmirësimin e nivelit aktual të mbulimit të kostove O&M me synimin drejt mbulimit 100%.

d) Shlyerjen e detyrimeve të prapambetura ndaj të tretëve. Referuar pasqyrave financiare 2017 këto detyrime janë në shumën 57,6 milionë lekë të cilat duhet të përballohen me tarifa por dhe me subvencione nga ana e qeverisë.

e) Përballimin e riparimeve në rrjetin e ujësjellësit, pasi raportohen defekte të shumta.

f) Blerjen e matësve individualë me qëllim përmirësimin e treguesit "Niveli i matjes".

g) Mundësinë e implementimit të sistemit kompjuterik për faturimet, pasi aktualisht mbahet në mënyrë manuale.

h) Marrja e shërbimit të kanalizimeve nga UK Tropojë, për qytetin Bajram Curri kërkon kosto shtesë për të përballuar këtë shërbim.

i) Shoqëria synon realizimin e një objektivi ambicioz për rritjen e orëve mesatare të furnizimit me ujë të pijshëm për të gjithë zonën e shërbimit nga 10 orë në vitin 2017, në 22 orë në vitin 2019.

j) Përmirësimi i nivelit të humbjeve nëpërmjet investimeve të vogla nga vetë shoqëria, kryesisht në

zonën rurale ku dhe humbjet e ujit janë më të mëdha, si dhe nëpërmjet legalizimit të lidhjeve të paligjshme.

k) Subvencionimi nga ana e qeverisë ka qenë në shuma të pa konsiderueshme referuar nevojave të shoqërisë, të cilat kanë shkuar për shlyerjen e kostove të energjisë elektrike. Për vitet 2017 dhe 2018 janë përfituar përkatësisht nga 3 milion lekë.

5. ERRU, gjatë procesit të analizës teknike ekonomike sipas metodologjisë së llogaritjes së tarifave të përcaktuar në vendimin nr.42, ka kërkuar nga UK Tropojë informacion shtesë, si dhe verifikim të saktësisë së të dhënave, të cilat janë vënë në dispozicion.

6. ERRU, në vlerësimin e tarifave të propozuara dhe treguesve të performancës, si dhe në analizën ekonomike financiare, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Tropojë të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe të akteve nënligjore dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë mbrojtjen e konsumatorëve nga çmimet monopol;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar (ligji nr. 9121), për mos lejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes nëpërmjet vendosjes, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të çmimeve të padrejta të shitjes apo e kushteve të tjera të tregtimit;

c) kërkesave të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorëve", të ndryshuar, (ligji nr. 9902);

d) orientimin drejt mbulimit të kostove O&M në nivelin 98% pasi aktualisht shoqëria bën pjesë në grupin e shoqërive që mbulon 83% të këtyre kostove.

e) tarifat e propozuara nga operatori të jenë në përputhje të plotë me parimin ligjor rregullator mbi përballueshmërinë, sipas të cilit tarifat duhet të jenë të përballueshme.

f) tarifat e propozuara nuk sjellin për pasojë efekte negative në mjedis nga veprimtaria e operatorit në zonën e shërbimit që ato do të aplikohen.

g) propozimin për ndryshimin e tarifave nga shoqëria, ERRU-ja e gjen të justifikuar, por jo në nivelin e propozuar për sa i përket tarifave volumetrike për dy shërbimet ujë dhe kanalizime, si dhe tarifën fikse të shërbimit.

7. ERRU-ja, në bazë të analizës, verifikimeve dhe komunikimit me stafin drejtues të shoqërisë i konsideron të arritshëm objektivat mbi treguesit e performancës dhe për këtë rekomandon:

a) Të ndjekë në mënyrë periodike ecurinë sipas planit të kostove dhe të ardhurave me qëllim realizimin e treguesit "Mbulimi i kostove O&M" në nivelin e parashikuar.

b) Të shlyej në kohë detyrimet ndaj shtetit dhe të tretëve me qëllim që të paguajë vetëm kostot e nevojshme dhe jo kostot shtesë të pajustifikuara.

c) Të hartojë plan veprimi për arkëtimin e debive të prapambetura duke ndjekur dhe hapat ligjorë për sistemimin e llogarive të klientëve pa shpresë kthimi me qëllim që në të ardhmen të arrijë të planifikojë provizionime për mbylljen e tyre.

d) Të intensifikoje përpjekjet për rritjen e përqindjes së arkëtimit korrent të faturave të vitit, me qëllim që norma e arkëtimit korrent për vitin 2019 të arrijë nivelin 75%.

e) Të shikojë mundësinë e hartimit të një Plan Biznesi me qëllim përcaktimin e synimeve, si dhe rrugët për arritjen e tyre, përcaktimin e nevojës për të ardhura, si dhe nivelin tarifor për një periudhe 5 vjeçare.

f) Shoqëria detyrimisht në vitin 2020 duhet të mbajë në kontabilitet me qendra kostoje të ndara për shërbimin e furnizimit me ujë dhe ato të kanalizimeve të ujërave të ndotura, në mënyrë që tarifat të orientohen drejt kostove përkatëse.

g) Të pajiset me matës të mëdhenj në të gjitha pikat e prodhimit të ujit, si dhe në pikat kryesore të rrjetit.

h) Të ngrejë task-forcën për gjetjen dhe eliminimin e të gjitha lidhjeve të paligjshme në rrjetin e transmetimit dhe të shpërndarjes.

i) Për të hartuar Bilancin e Ujit sa më real, në të gjithë nën zërat e tij, duhet të mbajë evidenca mbi defektet e ndodhura gjatë vitit në sistemin e furnizimit, të përllogaritë sasitë e humbura të ujit para riparimit dhe gjatë riparimit. Gjithashtu gjatë periudhës që shoqëria nuk ka të instaluar matës në prodhim, duhet të mbajë regjistra ku të pasqyrohet sasia ditore e ujit që prodhohet bazuar në treguesit e pompave në operim dhe numrit të orëve të punës së tyre.

j) Të fillojë procesi i identifikimit fizik të aseteve për shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime pasi ka mungesë informacioni lidhur me to (sidomos për shërbimin me kanalizime ku asetet

janë vetëm në vlerë monetare) në mënyrë që të mundësohet hartimi i Planit të Menaxhimit të Aseteve.

Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi vlerësoi tarifat e propozuara nga operatori mbi bazën e Metodologjisë të miratuar me vendim nr. 42, datë 9.12.2015 "Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura", si dhe akteve të tjera rregullatore që lidhen me të, arrin në konkluzionin se tarifat e propozuara sipas analizës së kryer janë të bazuara dhe në zbatim të kritereve ligjore referuese lidhur me kostot e pranueshme dhe të justifikuara, si dhe përballueshmërinë, nuk janë të padrejta dhe të vendosura në kushtet e abuzimit me pozitën dominuese në treg të operatorit ekonomik në kuptim të ligjit nr. 9121, "Për mbrojtjen e Konkurrencës", të ndryshuar, dhe ligjin nr. 9902 "Për mbrojtjen e konsumatorëve", për gjithë sa më sipër, në zbatim të nenit 13, 14 dhe 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave për shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Tropojë si më poshtë:

Kategoria	Tarifat sipas njësive administrative	
	Bajram Curri	**Bujan, Bytyc Fierzë, Llugaj, Margega, Tropojë, Lekbibaj**
Tarifë volumetrike për furnizimin me ujë	Lekë/m^3	Lekë/m^3
Konsumatorë familjarë	40	30
Konsumatorë publik	80	80
Konsumatorë privat	80	80
Tarifë volumetrike për KUN	Lekë/m^3	Lekë /m^3
Konsumatorë familjarë	13	-
Konsumatorë publik	22	-
Konsumatorë privat	22	-
Tarifë fikse	Lekë /muaj/lidhje	Lekë /muaj/lidhje
Konsumatorë familjarë	100	100
Konsumatorë publik	100	100
Konsumatorë privat	100	100

2. Objektivat e treguesve kryesorë të performancës të vitit 2019, për shoqërinë UK Tropojë të jenë:

Treguesit e performancës	Njësia e matjes	Niveli i objektivit të përcaktuar nga ERRU-ja
Mbulimi i kostove O&M	%	94.4
Uji pa të ardhura	%	58
Niveli i matjes	%	93
Vazhdimësia e furnizimit me ujë	orë/ditë	22
Eficienca e stafit	staf/1000 lidhje	10
Mbulimi me ujë	%	54
Mbulimi me KUN	%	30
Norma e arkëtimit korente	%	75

3. Pagesa rregullatore vjetore për shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Tropojë sh.a. do të jetë 0.6% e të ardhurave vjetore të parashikuara nga aktiviteti.

4. Lidhjen e kontratës me UK Tropojë brenda 30 ditëve nga data e njoftimit sipas pikës 4, të nenit 22, të ligjit nr. 8102.

5. Vendimi nr. 29, datë 13.10.2004 "Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a. Ujësjellës Tropojë", shfuqizohet.

6. Ky vendim hyn në fuqi më datë 1.8.2019 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

VENDIM
Nr. 30, datë 20.6.2019

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË LARGIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA PËR SHOQËRINË UJËSJELLËS-KANALIZIME MALËSI E MADHE SHA

Në mbështetje të nenit 13, 14, 21 dhe 22 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (ligji nr. 8102), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 39, datë 9.12.2015 "Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura" (vendimi nr. 39), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 9.12.2015 "Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura" (vendimi nr. 40), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 9.12.2015 "Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura" (vendimi nr. 41), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 9.12.2015 "Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura" (vendimi nr. 42),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 20.6.2019, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike mbi kërkesën e Ujësjellës-Kanalizime Malësi e Madhe sh.a. për miratimin e tarifave të për largimin e ujërave të ndotura

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Malësi e Madhe (UK Malësi e Madhe), me shkresën nr. 75 prot., datë 18.2.2019, ka aplikuar pranë ERRU për miratimin e tarifave për shërbimin e largimit të ujërave të ndotura, për të tre kategoritë e konsumatorëve të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 8102 dhe vendimin nr. 40.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR), pasi e gjeti paraqitjen e kërkesës për vendosjen e tarifave për largimin e ujërave të ndotura të shoqërisë UK Malësi e Madhe në përputhje me përcaktimet dhe procedurën e parashikuar në vendimin nr. 40, me vendimin nr. 20, datë 19.4.2019, vendosi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për propozimin e bërë nga UK Malësi e Madhe për nivelin e ri tarifor për shërbimin e largimit të ujërave të ndotura për popullsinë që e përfiton këtë shërbim.

3. UK Malësi e Madhe, nëpërmjet shkresës nr. 75 prot., datë 18.2.2019 "Kërkesë për nivel të ri tarife për largimin e përpunimin e ujërave të ndotura" për të tri kategoritë e konsumatorëve ka paraqitur propozimin si më poshtë:

- Konsumatorë familjarë 12 lekë/m^3
- Konsumatorë institucione 15 lekë/m^3
- Konsumatorë privat15 lekë/m^3

Nevoja e përcaktimit të tarifave nga ana e UK Malësi e Madhe me qëllim gjenerimin e të ardhurave shtesë argumentohet si më poshtë:

- Detyrimin ligjor që ka shoqëria për të pasur tarifa të miratuara nga ERRU për shërbimin e kanalizimeve.
- Përmirësimin e nivelit të mbulimit të kostove të operimit dhe mirëmbajtjes.
- Nevojën për të ardhura për mbulimin e kostove të nevojshme për të ofruar shërbimin e ri të kanalizimeve siç mund të jenë kostot e shtrimit të linjave, kosto e riparimeve, zhbllokime etj.

4. ERRU, në vlerësimin e tarifave të propozuara, si dhe në analizën ekonomike financiare, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Malësi e Madhe të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe të akteve nënligjore dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë mbrojtjen e konsumatorëve nga çmimet monopol;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" të ndryshuar (ligji nr. 9121), për mos lejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes nëpërmjet vendosjes, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të çmimeve të padrejta të shitjes apo e kushteve të tjera të tregtimit;

c) Kërkesave të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorëve" të ndryshuar (ligji nr. 9902);

d) Orientimin drejt Mbulimit të kostove O&M për të gjithë aktivitetin e shoqërisë në nivelin 94.5% pasi aktualisht këto kosto mbulohen 90% me të ardhurat nga aktiviteti UK.

e) Tarifat e propozuara nga operatori të jenë në përputhje të plotë me parimin ligjor rregullator mbi përballueshmërinë, sipas të cilit tarifat duhet të jenë të përballueshme.

5. ERRU, në bazë të analizës, verifikimeve dhe komunikimit me stafin drejtues të shoqërisë rekomandon:

- të krijojë inventarin e aseteve për shërbimin e largimit të ujërave të ndotura si dhe atë të furnizimit me ujë;
- të hartojë një plan në drejtim të zgjerimit të këtij shërbimi, për investimet në sistemin e largimit të ujërave të ndotura dhe për riparimet apo zëvendësimet me kosto të lartë të rrjetit ekzistues;
- të mbajë të ndara kostot për të dy shërbimet që ofron: shërbimin e furnizimit më ujë dhe atë të largimit të ujërave të ndotura me qëllim që shërbimet të orientohen drejt kostos reale të tyre.

Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi vlerësoi tarifat e propozuara nga operatori mbi bazën e Metodologjisë të miratuar me vendim nr. 42, datë 9.12.2015 "Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura" si dhe akteve të tjera rregullatore që lidhen me të, arrin në konkluzionin se tarifat e propozuara sipas analizës së kryer janë të bazuara dhe në zbatim të kritereve ligjore referuese lidhur me kostot e pranueshme dhe të justifikuara si dhe përballueshmërinë, nuk janë të padrejta dhe të vendosura në kushtet e abuzimit me pozitën dominuese në treg të operatorit ekonomik në kuptim të ligjit nr. 9121, "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar, dhe ligjin nr. 9902 "Për mbrojtjen e konsumatorëve", për gjithë sa më sipër, në zbatim të nenit 13, 14 dhe 22, të ligjit nr. 8102 datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave për shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Malësi e Madhe si më poshtë:

Kategoria	Tarifat sipas Njësisë Administrative Koplik
	Tarifë volumetrike për KUN
	Lekë/m³
Konsumatorë familjarë	12
Konsumatorë publikë	15
Konsumatorë privatë	15

2. Pagesa rregullatore vjetore për shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Malësi e Madhe sh.a. do të jetë 0.6% e të ardhurave vjetore të parashikuara nga aktiviteti.

3. Lidhjen e kontratës me UK Malësi e Madhe brenda 30 ditëve nga data e njoftimit sipas pikës 4 të nenit 22, të ligjit nr. 8102.

4. Ky vendim hyn në fuqi më datë 1.8.2019 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. (11-2019-2882) 783, datë 24.5.2019, vendosi shpalljen të zhdukur të shtetasit Artan Sherbet Spanjolli, i datëlindjes 25.8.1969.

VENDIM
(*i shkurtuar*)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. (11-2019-2908) 794, datë 27.5.2019, vendosi të shpallë vdekjen në datën 30.11.1997 të shtetasit Arianit Xhemal Skilja, i datëlindjes 26.6.1971.

KËRKESË

Shtetasja Fatmire Sula kërkon, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, shpalljen të zhdukur të shtetasit Lulzim Rasim Sula, i datëlindjes 5.4.1968 si dhe caktimin e saj si kujdestare për administrimin e pasurisë së tij.

KËRKUESE
Fatmire Sula

KORRIGJIM GABIMI MATERIAL

Në vendimin nr. 95, datë 17.06.2019 "*Mbi miratimin "Udhëzuesit për testimin e tregut për gazsjellësin Trans Adriatik",* botuar në Fletoren Zyrtare nr. 101, datë 12 korrik 2019 bëhet korrigjimi i gabimit material si më poshtë:

Dispozitivi i vendimit:

Ishte:

1. Të miratojë "Udhëzuesin për Testimin e Tregut për Gazsjellësin Trans Adriatik" dokumenti i paraqitur i propozuar nga TAP AG.

2. Në rast mos – pajtueshmerie të kërkesave të kapacitetit me limitet e kapacitetit, Autoritetet do të njoftojnë me shkrim Palën e Interesuar. Në mungesë të këtij njoftimi, kërkesa konsiderohet e përmbushur.

3. Versioni në gjuhën e origjinës (Anglisht), ka përparësi në rast mosdakordësie në interpretim nga palët të versionit Shqip.

Bëhet:

1. Të miratojë "Udhëzuesin për Testimin e Tregut për Gazsjellësin Trans Adriatik" dokumenti i paraqitur i propozuar nga TAP AG, në date 14 June 2019

(Aneks B, i dakortësuar në vendimin e përbashket në vijim Ankesi A, bashkëlidhur këtij vendimi).

2. Në rast mos – pajtueshmerie të kërkesave të kapacitetit me limitet e kapacitetit, Autoritetet do të njoftojnë me shkrim Palën e Interesuar. Në mungesë të këtij njoftimi, kërkesa konsiderohet e përmbushur.

3. Versioni në gjuhën e origjinës (Anglisht), ka përparësi në rast mosdakordësie në interpretim nga palët të versionit Shqip.

4. Aneksi A dhe B i këtij vendimi do të publikohen në faqen e internetit të ERE-s pas publikimit të tij në faqen e internetit nga Tap Ag.

5. Të përcjellë këtë vendim në Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në Autoritetin e Konkurrencës, në RAE, në ARERA dhe shoqërinë TAP AG.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 574 lekë